

PROGRAMI KOMBËTAR I MONITORIMIT TË MJEDISIT PËR VITIN 2020

Përgatitur nga:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Rruga "Sami Frashëri" Godina Nr.4 Kati 2

Tel/Fax: [+355 42 371 242](tel:+35542371242)/[+355 42 371 237](tel:+35542371237)

Email: info@akm.gov.al

www.akm.gov.al

Programi u hartua nga Sektori i Cilësisë së Mjedisit mbështetur nga Drejtoria e Pyjeve ,Drejtoria e Informacionit dhe e Menaxhimit të të Dhënave dhe Sektori i Laboratorit.

TIRANË 2019

TABELA E PËRMBAJTJES

1 Sistemi i Integruar i Monitorimit të Mjedisit	3
1.1 Programi Kombëtarë i Monitorimit të Mjedisit 2020	3
1.1.1 Sistemi i monitorimit Monitorimi	6
1.1.1.1 Temat kryesore të indikatorëve dhe nën indikatorëve ose parametrave të sistemit	10
1.1.1.2 Karakteristikat baze të indikatorit Skedat teknike të indikatorit	23
1.1.2 Kostimi dhe Buxhrtimi	88
Aneksi 1	103
1.1 Programi i Monitorimit të Ajrit	103
Tipi i monitorimit të Ajrit	103
Automatik (A)	103
Tubat Pasiv (PT)	103
Kampionaturat Tecora PM	104
Kampionaturat Tecora PM	104
Zhurmat	104
Harta e Ajrit	105
Rrjeti i Ajrit	105
Rrjeti i Zhurmave	108
1.2 PM të Ujit	109
Tipet e monitorimit të Ujit	109
Lumi	109
Liqen	111
Lagunë	111
Ujë i Detit	112
Sedimente	112
Kushtet Bio dhe Ekol.te Ujrave të Brendshme	112
Harta e Monitorimit US	113
Rrjeti i Monitorimit US	114
Lumi	114
Liqen	127
Lagunë	131
Ujë i Detit	133
Kushtet Bio dhe Ekol.te Ujrave të Brendshme	140
1.3 PM e Ujrave Nëntokesorë	143
Tipet e Monitorimit të UN	143
Harta e Monitorimit UN	144
Rrjeti i Monitorimit UN	144
1.4 PM të Tokës	145
Tipet e Monitorimit të Tokës	145

	Rrjeti i Monitorimit të Tokës	146
1.5	PM të Pyjeve	147
	Tipet e Monitorimit të Pyjeve	147
	Rrjeti i Monitorimit të Pyjeve	148
1.6	PM iBiodiversitetit	154
	Harta e Monitorimit të Biodiversitetit	155
	Rrjeti i Monitorimit të Biodiversitetit	156
	Lista e Shkurtimeve	166
	Referencat	167

1 PROGRAMI KOMBËTARE I MONITORIMIT TË MJEDISIT PËR VITIN 2020

1-Sistemi i Integruar i Monitorimit te Mjedisit

Përgatitja e sistemit të monitorimit synon të ndihmojë autoritetet kombëtare shqiptare që po përdorin një sistem të integruar të monitorimit mjedisor, që mbulon të gjithë komponentët: ajrin, ujërat, tokën, pyjet dhe biodiversitetin në formën e një seti stacionesh monitorimi për secilin komponent, e shoqëruar me një set indikatorësh për të cilat duhet raportuar. Rrjete të tilla janë përcaktuar në përputhje me kërkesat e Acquis të BE-së.

Planifikimi bazohet në parashikimet e VKM-së dhe paraqet mekanizmat ekzistues dhe përpjekjet e programimit. Objektivi kryesor është ofrimi i një kuadri të rishikuar i cili do të sigurojë funksionalitet (funksional – indikatorë të pajtueshëm), efikasiteti (i vlefshëm për të përgatitur dhe vlerësuar politikën) dhe efienca (duke marrë parasysh kapacitetet teknike dhe burimet financiare).

1.1 Programi Kombëtar i Monitorimit te Mjedisit 2020

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2020(PKMM) do të bazohet në parimet e mëposhtme:

Konteksti politik: Objektivi primar i PKMM është të ndihmojë autoritetet kombëtare dhe vendimmarrësit në arritjen e qëllimeve të politikës për një zhvillim të qëndrueshëm. Këto përfshijnë si angazhimet kombëtare dhe objektivat për Zhvillim, së bashku me objektivin për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Për ta arritur këtë objektiv nevojitet të zgjidhen elementet më të përshtatshëm (indikatorët) të cilët nga njëra anë mbulojnë angazhimet, ndërsa nga ana tjetër përmbajnë informacion të vlefshëm për politikëbërësit me qëllim promovimin e axhendës së zhvillimit.

Qëllimi: Në këtë program duhet të lidhet mirë "cfarë ne monitorojmë" me "si ne monitorojmë" dhe "si synojmë t'i përdorim rezultatet.

Masa: Do të përcaktojë kufijtë të cilët do të vendosin sesa përpjekje duhet të bëjmë për arritjen e qëllimeve.

Konteksti politik

Monitorimi është: Mbledhja sistematike e informacionit që i mundëson aktorët për të kontrolluar nëse një nismë është në rrugën e duhur apo po arrin të plotësojë disa objektiva.

Konteksti politik është burimi kryesor i cili vendos lidhur me këto objektiva. Konteksti më i gjërë politik lidhet me politikën kombëtare mjedisore dhe kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe siguron udhëzime për të projektuar sistemin më të përshtatshëm të monitorimit. Objektiva ose politika të përgjithshme ose specifike që trajtojnë zhvillimin e qëndrueshëm mund të këtë dhe mund të përfshijnë një mandat për monitorimin.

Instrumenti kryesor për të zbuluar kontekstin politik në Shqipëri është VKM-ja 1189 për monitorimin. Vendimi i përcaktuar si objektivi primar për monitorimin, i cili është zbatimi efektiv i politikës kombëtare të mbrojtjes së mjedisit, siç specifikohet në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Krahas kësaj, përmendim dispozitën për zgjerimin e sistemit kombëtar të monitorimit mjedisor me qëllim plotësimin e kërkesave të BE-së/AEM-së, ky vendim përbën një udhëzues të dytë politik. Ky udhëzues i referohet objektivit kombëtar strategjik të hyrjes në BE i cili lidhet me adoptimin dhe përputhshmërinë në politikën e BE-së. (*Acquis Communautaire*).

Qëllimi:


Përkufizimi i qëllimit është shumë i rëndësishëm për sistemin e monitorimit, ajo lidhet "çfarë dhe si monitorojmë" me "si synojmë t'i përdorim rezultatet e monitorimit". Ka tre përdorime kryesore të rezultateve të monitorimit (të cilat mund të aplikohen në të njëjtën kohë):

- Të mësosh,
- Të japësh llogari,
- Dhe të adaptosh menaxhimin

DPSIR jep një kuadër logjik për të aplikuar lidhjet midis "çfarë" dhe "si". Ky model (i adoptuar si modeli kryesor i monitorimit mjedisor nga AEM që nga viti 1999) lidh shtytësit e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik (D) ndryshimet që ushtrojnë trysni (P) mbi gjendjen (S) e mjedisit, i cili shoqërohet me impakte (I) mbi shëndetin e njerëzve, funksionimin e ekosistemit dhe ekonominë. Në fund, përgjigjet shoqërore dhe politike (R) influencojnë në pjesët e para të sistemit, në mënyrë direkte ose indirekte.

E parë nga perspektiva e politikës, dhe me qëllim vendosjen e lidhjeve, kemi një nevojë të qartë për indikatorë në të gjitha pjesët e zinxhirit DPSIR (AEM, 2010),

Modeli DPSIR (AEM 2014, pas Eurostat/AEM 1999)



Grumbullimi ka të bëjë me përmbledhjen e të dhënave në shkallën e përshtatshme. Kemi dy nivele të grumbullimit:

Horizontal (përmes fushave tematike dhe sektorëve): Sektorët prioritarë mund të identifikohen në një politikë ose plan dhe/ose në vlerësime sektoriale. Inventari kombëtar i GES, për shembull, grumbullon inventarët e gjithë shkarkimeve sektoriale me qëllim përcaktimin e indekseve të përgjithshme.

Vertikal (përmes niveleve gjeografike): Ky nivel është i rëndësishëm kur një sistem duhet të marrë në konsideratë të dhënat që ekzistojnë në shume nivele lokale, për nga organet e pushtetit vendor, komunitetet, organet menaxhuese. Grumbullimi vertikal është kryesisht i vlefshëm në monitorimet me bazë hapësinore si për biodiversitetin dhe vlerësimin e cilësisë së ujit.

Grumbullimi nuk kushtëzohet vetëm në analizat sasiore, por mund t'i referohet gjithashtu

sintetizimit të rezultateve cilësore.

Një dimension tjetër i nivelit ka të bëjë me shkallën e kohës. Shkalla e kohës dhe caktimi i afateve kohore kanë shumë rëndësi në sistemet e shumëllojshme të monitorimit ku fenomeni që po vërehet ka nivele variabël të ndryshimit. Ka rrethana të rastit kur koha duhet marrë në konsideratë në procesin e programimit të sistemit të monitorimit:

- Koha e matjes dhe grumbullimit të të dhënave: në shume raste për arritjen e një përshkrimi të besueshëm të një fenomeni natyror, koha e matjes ose e kampionimit ka rëndësi shumë të madhe. Fenomenet natyrore për shembull duhen monitoruar në mënyrë të vazhdueshme dhe grumbullimi vjetor (ose stinor/mujor/ditor) me qëllim që të sigurojnë një informacion të vlefshëm. Nga ana tjetër monitorimi i specieve mund të jetë i vlefshëm në periudha të përcaktuara kohore.
- Frekuenca e raportimit: monitorimi shpreh një ndryshim (ose stabilitet) të një gjendjeje aktuale në kohë dhe hapësirë. Një vrojtimi jo shumë të shpeshtë të gjendjes mund t'i mungojnë disa luhatje të ndërmjetme të situatës. Një vrojtım më i shpeshtë mund të harxhojë burime njerëzore dhe financiare pa siguruar ndonjë gjë të vlefshme apo të panjohur.

1.1.1 Sistemi i Monitorimit

Institucionet që ngarkohen nga VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009 për zbatimin e PKM

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Informacioni që duhet të paraqesë institucioni që do të kryejë monitorimin (para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit)

- Institucioni monitorues
- Detyrat e monitorimit
- Parametrat që do të monitorohen
- Metoda e matjeve
- Marrja e mostrave :parimi,transporti,ruajtja e mostrave .
- trajtimi paraprak i mostrave .
- Parimi i analizës
- Literatura nga është marrë metoda e analizës
- Ndryshimet nga metodika e rekomanduar në literaturë dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në rezultatet e analizave .

Stafi monitorues:

- Përbërja e stafit që do të marrë pjesë në monitorim .
- Kualifikimi i stafit :diplomimi ,specializimi ,grada dhe titujt shkencorë etj.
- CV e stafit të lartë që marrin pjesë në monitorim
- Aparaturat reaktivet dhe mjetet e tjera.
- Aparatet viti i prodhimit, gjëndja e tyre .
- Reaktivet , cilësia ,firma nga merren . Mjetet e tjera laboratorike .
- Përvoja e institucionit monitorues , projektme ose studime të ngjashme .
- Pjesëmarrje në monitorime mjedisore të mëparshme .

- Pjesmarrje në projekte dhe studime mjedisore .
- Vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë së analizave.
- Metoda(t) që përdor laboratorit për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë.
- Kalibrimi i mjeteve matëse dhe aparaturave .
- Metodatat e kalibrimit
- Kontrolli i performancës së mjeteve matëse nga Instituti i Meteorologjisë ose institucione të tjera
- Teknika llogaritëse
- Programet kompjuterike që përdoren për përpunimin dhe vlerësimin e të dhënave të monitorimit .
- Vlerësimi i të dhënave
- Ku bazohet vlerësimi i të dhënave të marra nga monitorimi
- Paraqitja e rezultateve të monitorimit .
- Koha e raportimit dhe mënyra e raportimit .
- Kostoja e analizave .

Publikimi i RGJM-se është një detyrë që duhet realizuar duke inkorporuar edhe progresin vit pas viti të monitorimit.

Hapi tjetër për përgatitjen e planit të monitorimit lidhet me përkufizimin e sistemit të informacionit. Teknikisht, një sistem i monitorimit të informacionit përmban hapat e mëposhtëm:

a-Detyrën e komunikimit e cila merr informacionin nga një burim informacioni (një censor automatik ose regjistër manual) dhe ia komunikon këtë informacion një sistemi marrës të informacionit;

b-Përpunimi paraprak i të dhënave duke kaluar nëpër hapa si kalibrimi, kontrollimi dhe formatimi;

c-Ruajtja e të dhënave në një lloje bazë të dhënash;


d-Paraqitja e të dhënave në një formë të përshtatshme për përdoruesit.

Pothuajse të gjithë të dhënat e disponueshme aktualisht janë të dhëna hapësinore. Këto të dhëna tregojnë së çfarë po ndodh dhe ku, kuptohen lehtësisht nga publiku dhe komunikohen lehtësisht në procesin e vendimmarrjes. Propozohet kalimi në sistemin GIS.

Modelet GIS (UoE FAF 2012)

Could it be....?

Measuring and Integrating a multitude of attributes together to answer a common...



To Help See the Whole Picture



Të dhënat hapësinore janë të dhëna vektor. Ato përmbajnë referenca gjeohapësinore si koordinatat e një pike ose format e zonave fizike, po në fakt ato përfshijnë shumë karakteristika plotësuese. Në këtë drejtim, të dhënat hapësinore ofrojnë kontekstin e informacionit mjedisor i cili ka shumë rëndësi në të kuptuarin dhe vlerësimin e asaj që po ndodh. Teknologjia GIS të lejon të punosh me të dhëna hapësinore që vijnë nga një gamë e gjerë burimesh. Disa vijnë nga imazhet satelitore, disa vijnë nga sensorë automatikë dhe të tjerë nga logime manuale në programet e monitorimit në tokë. Teknologjitë më të reja mund të përdoren nga qytetaret si për shembull nëpërmjet aplikacioneve në telefonat celularë.

Për të pasur një sistem funksional të monitorimit që bazohet në GIS, duhet të plotësohen disa kushte. Kushti i parë është teknologjik. Softuerë dhe harduerë të posaçëm duhet të instalohen dhe lidhen. Këto i referohen sistemit qendror i cili do të marrë, ruajë, menaxhojë dhe përpunojë të dhënat te sistemet periferike të cilat do të përdoren për të hyrë dhe për të parë të dhënat nga pjesëmarrësit dhe rrjeti. Kushti i dytë ka të bëjë me krijimin e një "hyrjeje" dhe protokolleve të cilat do të vërtetojnë cilësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave. Kushti i tretë lidhet me trajnimin (dhe dhënien e certifikatave) e përdoruesve. Dhe kushti i katërt ka të bëjë me krijimin e sfondeve të përshtatshme (background).

Ndërsa sistemi i monitorimit GIS instalohet, tre janë funksionet e tij kryesore:

- Analizimi i të dhënave: analizat hapësinore të të dhënave gjeografike për vlerësimin dhe modelimin e proceseve dhe situatave.
- Menaxhimi i të dhënave: ruajtja dhe sistemimi i volumeve të mëdha të të dhënave të monitorimit, zhvillimi i bazës së të dhënave dhe sistemet e aplikuara kompjuterike.
- Prezantimi i të dhënave: publikimi i hartave dhe rezultateve në formë dixhitale dhe të printuar

Direktiva INSPIRE (infrastruktura për informacionin hapësinor në Evropë) kërkon ndarjen e 34 temave të ndryshme të të dhënave hapësinore nëpërmjet një rrjeti "shërbimesh". INSPIRE kërkon gjithashtu adoptimin e "rregullave të zbatimit" të cilat përcaktojnë sesi do të funksionojë sistemi.¹

QA është një set aktivitetesh për të siguruar cilësinë në proceset ku zhvillohen të dhënat. Ndërsa QC është një set aktivitetesh që sigurojnë cilësinë e të dhënave dhe këto aktivitete fokusohen në identifikimin e defekteve në produktin aktual të prodhuar. Një vlerësim i procedurave QA/QC është i nevojshëm për çdo set të dhënash të cilat përbëjnë në total masat e sigurisë që do të sigurojnë besueshmërinë e sistemit të monitorimit. Rezultati i një vlerësimi të tillë do të përfundojë me përcaktimet e protokolleve të logimit të cilat do të përfshijnë procedurat dhe rregullat të cilave duhet t'i referohemi.:

- Cilat janë karakteristikat kryesore të cilat duhet të regjistrohen?
- Si dhe me çfarë standardesh do të matet dhe regjistrohet informacioni?
- Si dhe me çfarë standardesh informacioni duhet të përfshihet në bazën e të dhënave?
- Cilat janë të dhënat të cilat duhet të shoqërojnë informacionin parësor (meta data)?

Politika e sigurisë ofron siguri dhe besueshmëri të të dhënave/mbledhjen e kampioneve, proceset fizike ose laboratorike, procedurat e ruajtjes dhe futjes. Siç do të prezantohet në vazhdim, shumica e procedurave të kampionimit dhe laboratorike janë standardizuar nga ISO ose organizata të tjera ndërkombëtare. Në rastin e procedurave dhe operacioneve të pastandardizuara, duhet të përgatiten protokolle përkatëse.

Për QC, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) do të kryejë kontrollin e cilësisë së të dhënave të marra nga institucionet monitoruese dhe kontrollon dhe vlerëson procedurat e monitorimit. Qëllimi i vlerësimit të cilësisë së të dhënave është:

- Të parandalojë përdorimin e të dhënave të gabuara në vlerësimin e statusit të mjedisit dhe aktiviteteve të lidhura.
- Të dhënat e monitorimit, të marra nga institucione të ndryshme dhe në kohë të ndryshme të jenë të krahasueshme. Kjo nënkupton se cilësia e të dhënave duhet të jetë e krahasueshme ose të paktën publike.
- Të dhënat e monitorimit të marra në kuadër të Planit Kombëtar të Monitorimit duhet të kenë cilësi të krahasuar me ato të vendeve të tjera dhe të jenë në përputhje me kërkesat e organizatave ndërkombëtare (në veçanti me kërkesat e indikatorëve mjedisor).
- Të përzgjedhë institucionin i cili tregohet me i besueshëm për sa i përket cilësisë së rezultateve të monitorimit.

¹ <http://www.inspire-geoportal.eu/>

Temat kryesore të indikatorëve dhe nën indikatorëve ose parametrave të sistemit të monitorimit janë:

<i>Ndryshime klimatike (adaptimi dhe zbutja)/Energji / Transport:</i>	<i>Temperatura mesatare e ujit/valët e të nxehtit, Niveli i detit, shirat/stuhitë, Niveli i ujërave nëntokësore, konsumi final i energjisë sipas sektorëve/Konsumi primar i energjisë nga karburanti, shkarkimi i gazit me efekt serrë nga transporti, inventari i gazeve me efekt serrë nga transporti, inventari i gazeve me efekt serrë në 5 sektorë bazë, inventari LULUFC, pjesa e energjisë se rinovueshme në konsumin final të energjisë, Efiçenca e energjisë (transport, banesa, industri)</i>
<i>Ndotja e ajrit, Kushtet atmosferike dhe zhurmat:</i>	<i>Kërkesa për transportin e pasagjereve/mallrave, reshjet atmosferike (SO₂, NO_x Pb), Shkarkimet e ndotësve urbane të ajrit (PM, SO₂, NO_x, O₃, CO, HC), Shkarkimet e ndotësve të metaleve të rënda të ajrit (Pb, As, Mn, Ni, Cu, Zn, Cd), Nivelet e zhurmës</i>
<i>Ujërat tokësore dhe ato të ëmbla:</i>	<i>Kushtet biologjike dhe ekologjike të ujërave tokësore (fitoplankton dhe zooplankton, klorofil, peshqit), intensiteti i shkarkimeve nga bujqësia në Evropë, kushtet morfologjike të ujërave tokësore (rrjedha, zona, dinamika e grykëderdhjeve), Intensiteti i shkarkimeve nga sektori familjar (shkarkimet e lëngëta urbane)</i>
<i>Ujërat detare:</i>	<i>Cilësia e ujit të detit ku lahemi, Fjetja në hotele, substancat e rrezikshme në organizmat detare, morfologjia bregdetare</i>
<i>Biodiversiteti:</i>	<i>Speciet/Habitatet me interes evropian, Zonat e përcaktuara, diversiteti i specieve, Fragmentimi i zonave natyrore dhe gjysmë natyrore, bujqësia: zona nën praktika menaxhimi potencialisht duke mbështetur biodiversitetin.</i>
<i>Pyjet:</i>	<i>C1). Mirëmbajtja, përmirësimi dhe rritja e burimeve pyjore, kontributi i tyre në ciklet globale të karbonit, (C2). Ruajtja e ekosistemeve pyjore, shtimi i pyjeve, (C3). Mirëmbajtja dhe inkurajimi i funksioneve prodhuese nëpër pyje, (C4). Mirëmbajtja, konservimi dhe përmirësimi i diversitetit biologjik në pyje, (C5). Mirëmbajtja, përmirësimi dhe stimulimi i funksioneve mbrojtëse në pyje, (C6). Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve të tjera social-ekonomike.</i>
<i>Të tjera:</i>	<p><i>Mbetjet e ngurta (gjenerimi, riciklimi, devijim nga landfilli), ndotësit e lëshuar në ajër, ujë dhe mbetje nga uzinat industriale, marrja e tokës, GDP-ja, popullsia e përgjithshme, peshkimi, progresi në menaxhimin e zonave të infektuara.</i></p> <p><i>Kimikatet (dioksinat, furanet dhe bifenilet e poliklorinuara (PCB), në përputhje me listën e paraqitur në Aneksin II, të VKM-se Nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”</i></p>

Parametrat që do të përdoren dhe përputhshmëria e secilit indikator me sistemin e AEM-së dhe me VKM-në jepet në tabelën në vazhdim.

Tabela 1: Sistemi i propozuar i Monitorimit

Tema	Indikatori	Nën indikator	Parametrat/ seti i të dhënave	Fokus	Indikatorë dytësorë	Klasifikimi AEM	VKM
Ndryshime klimatike	Temperatura mesatare e ajrit		1	S	Valë të nxehti (I)	CSI	Po
	niveli i detit		1	I			Po
	Sasia e reshjeve atmosferike		1	I	Stuhi, reshje ekstreme		Po
	Niveli i ujërave nëntokësore		6 / për ujëmbledhës	I			Po
	Konsumi final i energjisë sipas sektorëve/Konsumi primar i energjisë nga karburantet		2	DF			
	Shkarkime të gazit me efekt serrë nga transporti		1	P	Konsumi final i energjisë nga transporti		
	Inventari i shkarkimeve të GES për 5 sektorë bazë (energji, tretës, procese industriale, bujqësi, mbetje)	Tendencat e shkarkimeve me gazin me efekt serrë	1	P	Konsumi primar i energjisë nga karburanti		

	Inventari i shkarkimeve të GES i përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pyjeve		1	P				
	Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë	Hidro/Solar/Era/gjeotermike	1	R	Konsumi i energjisë së rinovueshme	CSI		
	Efiçenca e energjisë (rezidenciale dhe shërbimet, transport, industri)		1	R				
Ndotja e ajrit, kushtet atmosferike dhe zhurma	Kërkesa për transport pasagjerësh/mallrash		1 ose për qytet	DF		CSI		
	Reshjet atmosferike (SO ₂ , NO _x , Pb)		3 X 7 deri në 15 stacione	P			Po	
	Shkarkime të ndotësve urban të ajrit (PM, SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO, HC)	Shkarkime PM		1	P	% e popullsisë urbane ekspozuar me ndotjen e ajrit	CSI (total)	Po
		Shkarkime SO ₂		1	P			Po
		Shkarkime NO _x		1	P			Po
		Shkarkime O ₃		1	P			
		Shkarkime HC		1	P			Po
Shkarkime të ndotësve urbanë të ajrit nga metalet e rënda (Pb, As, Mn, Ni, cu, Zn, Cd)	Shkarkime Pb		2	P			Po	

	Nivelet e zhurmës		2	P	Popullsia e ekspozuar		Po
Ujërat e ëmbla	Kushtet fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore (alkaline, përcjellshmëria, aciditeti, COD / BOD5, ushqyesit PO4, NO3 dhe NH4, pH)	Substanca që konsumojnë oksigjenin në lumenj	2	S	Tendenca në statusin kimik		Po
		Ushqyesit në ujëra të ëmbla	4	S		CSI	Po
		Ushqyesit në ujëra kalimtare, bregdetare dhe detare	4	S			Po
	Kushtet biologjike dhe ekologjike të ujërave tokësore (fitoplankton dhe zooplankton, klorofil, peshqit)		4	S	Tendenca në statusin ekologjik	CSI /CSI (Indik. i dytë)	Po
	Intensiteti i shkarkimeve të bujqësisë		1	P			Po
	Kushtet fiziko kimike të ujërave nëntokësore (alkaline, përcjellshmëria, aciditeti, COD / BOD5, ushqyesit PO4, NO3 dhe NH4, pH)		1	S	Tendenca në statusin kimik		
	Kushtet morfologjike të ujërave tokësore (rrjedha, zona, dinamika e grykëderdhjeve)		3	P			Po
	Intensitetit i sektorit të brendshëm (lëshimet e lëngjeve urbane)		1	P			Po

Mjedisi detar	Cilësia e ujit për t'u larë		1	S	Flamuri Blu është dhënë	CSI	Po	
	Qëndrim me fjetje në hotel		1	DF				
	Substanca të rrezikshme në organizmat detare		1	P		CSI	Po	
	Morfologjia bregdetare		1	I				
	Peshkimi dhe peshqit	Statusi i rezervave të peshkut të detit		1	S			
		Prodhime akuakulture		1	P			
		Kapaciteti i flotës së peshkimit		1	P			
Biodiversiteti	Speciet/Habitatet me interes evropian	Habitatet, Flora, Fauna, deti/toka	2 deri 8	S		CSI	Po	
	Zonat e përcaktuara		1	R		CSI		
	Diversiteti i specieve		1	S			Po	
	Ndarja e zonave natyrore dhe gjysme natyrore		1	I		CSI	Po	

	Bujqësia: zonë nën praktikë menaxhimi potencialisht në mbështetje të biodiversitetit.		2	R	Zona bujqësore nën Natura 2000		Po
Pyjet	C1 Mirëmbajtja, përmirësimi dhe rritja e burimeve pyjore, kontributi i tyre në ciklet globale të karbonit		4	S		FE	Po
	C2 Ruajtja e ekosistemeve pyjore, shtimi i pyjeve		3	S		FE	Po
	C3 Mirëmbajtja dhe inkurajimi i funksioneve prodhuese nëpër pyje		2	R		FE	Po
	C4 Mirëmbajtja, konservimi dhe përmirësimi i diversitetit biologjik në pyje.		1	I		FE	Po
	C5 Mirëmbajtja, përmirësimi dhe stimulimi i funksioneve mbrojtëse në pyje.		1	I		FE	Po
	C6 Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve të tjera social-ekonomike		1	P		FE	Po
Të tjera	Ndotësit e lëshuar në ajër, ujë dhe mbeturina nga uzinat industriale		3	P		CSI	Po
	Mbetjet e ngurta:	Gjenerimi i mbetjeve	1	P		CSI	Po

		Riciklimi i mbetjeve	1	R		CSI	
		Depozitimi ilegal i mbetjeve	1	R		CSI	
	Skenarët mjedisorë	GDP		DF		CSI	
		Popullsi e përgjithshme	1	DF	Popullsia urbane/rurale	CSI	
	Toka	Progresi në menaxhimin e zonave të infektuara (grumbullimet e mbeturinave, për rehabilitim, mbyllje të zonave të infektuara)	1	R			

Monitorimi i Ndikimit në Mjedis ,i cili kryhet, ne saje te Zbatimit te Planit të Përgjithshëm Kombëtar

Sistemi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, i cili rrjedh nga zbatimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar, është një mjet i thjeshtë dhe efikas për t'u përdorur, për një monitorim sa më efektiv. Monitorimi i ndikimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit, dhe, në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktiven 2001/42/EC, zbatimi i një program duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme. Në këtë kuadër, është hartuar ky sistem monitorimi për ndikimet kryesore në mjedis, i cili do zbatohet nga ky Plan. Këto ndikime janë identifikuar gjatë Vlerësimit të ndikimeve mjedisore të planit përkatës. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversiteti, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji, peisazhi, trashëgimia kulturore, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar. Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime:

- (a) të dhënat e para që merren nga matja e parametrave të mjedisit, dhe
- (b) Vlerësimi i indikatorëve mjedisorë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes matjeve mund të realizohet duke përfshirë Autoritetet Rajonale (Qarqet), por edhe Institucionet Shtetërore (përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit), Pushtetin Lokal, institucione kërkimore shkencore dhe ato profesionale, si dhe ndërmarrjet e shërbimeve publike (lëndfilllet, ujesjelles – kanalizime etj.). Matja e indikatorëve mjedisore është një proces kompleks; ai është një proces që kryhet rregullisht dhe për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë këndvështrim ne duhet që të bazohemi në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga strukturat e tjera, duke theksuar, nga njëra anë, monitorimin e zbatimit të standarteve të nevojshme të matjeve nga strukturat e tjera, dhe kryesisht nga operatorët përkatës (përmes përfshirjes së tyre në procesin e nxjerrjes së lejeve përkatëse mjedisore), dhe nga ana tjetër, duke u përqëndruar tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Autoritetet Rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kontekst, autoritetet përkatëse duhet të planifikojnë dhe të veprojnë si një qender mbledhjeje, analizimi dhe shpërndarjeje të informacionit. Më konkretisht, roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

- Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në menyrë të perhershme, qoftë të përkohshme.
- Mbledhjen e të dhënave bazë që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (lëndfilllet, ujesjelles – kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.).
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore, etj.).
- Marrjen e të dhënave baze që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera.
- Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjëndjen e mjedisit në një zonë të caktuar.
- Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjëndjes së mjedisit në kohë të caktuara.
- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Keto raporte synojnë që:

- (a) të plotësojnë kërkesat e legjislacionit,

- (b) të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit (vendim-marrësit),
- (c) të informojnë publikun që preket nga Plani.

Tabela më poshtë paraqet programin e monitorimit të ndikimeve mjedisore të PPK. Tabela është hartuar sipas sektorëve të mjedisit si më poshtë:

Biodiversiteti, Popullsia, Shëndeti i njerëzve, Fauna, Flora, Toka, Uji, Ajri, Faktoret klimatike, Asetet e prekshme, Trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgimie arkitektonike dhe arkeologjike), Peisazhi

Lidhja mes këtyre faktoreve

Për çdo sektor mjedisor janë dhënë indikatorët përkatës, strukturat përgjegjëse për monitorimin, parametrat mjedisorë dhe frekuenca e monitorimit. Sic u përmend edhe më sipër, theksohet që monitorimi i ndikimeve të Planit në mjedis do të realizohet, aty ku është e mundur, duke përdorur të dhëna që dalin nga:

-Sistemi ekzistues i monitorimit të parametrave mjedisorë nga Ministria e Mjedisit (MM) apo institucione të tjera. Disa parametra që maten dhe japin të dhëna janë:

-Cilesia e ajrit (niveli i ndotjes),

-Cilësia e ujit (ujërat sipërfaqësorë, ujërat nëntokësorë, ujërat e plazhëve në bregdet).

-Studimë të vecanta dhe të pavarura për identifikimin e ndikimeve mjedisore në kuadër të programeve apo projekteve të tjera.

-Raportet e përgatitura nga kontraktorë/konsulentë të ndryshëm, më të dhëna të drejtperdrejta ose të referuara nga VNM-te individuale të projekteve specifike infrastrukturore të financuara nga buxheti i shtetit apo donatorët e huaj.

Tab nr 2

Monitorimi i ndikimeve në mjedis sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar

Nr	ASPEKTI MJEDISOR	INDIKATORI MJEDISOR	AUTORITETI MONITORUES	PARAMETRAT MJEDISORE	FREKUENCA E MONITORIMIT	KOMENTE
1	Biodiversiteti – fauna - flora	<input type="checkbox"/> Sa habitate te rëndësishme janë në gjëndje të kënaqshme? <input type="checkbox"/> Numri dhe /ose sipërfaqja me zona të mbrojtura <input type="checkbox"/> Permasat e biodiversitetit, krahasuar me BE (Numri i specieve endemike dhe të rralla <input type="checkbox"/> Sipërfaqja e mbuluar me pyje <input type="checkbox"/> Numri dhe sipërfaqja e mbuluar me zona natyrore	Strukturat e Menaxhimit te Zonave të Mbrojtura Drejtoritë përgjegjëse në qarqe	<input type="checkbox"/> Habitatet <input type="checkbox"/> Numri dhe /ose sipërfaqja me zona të mbrojtura <input type="checkbox"/> Numri i specieve endemike dhe të rralla <input type="checkbox"/> Sipërfaqja e mbuluar me pyje <input type="checkbox"/> Numri dhe sipërfaqja e mbuluar me zona natyrore	Sipas Planit te Menaxhimit Cdo vit	
2	Popullsia – shendetet i njerëzve	<input type="checkbox"/> Vitet e jetegjatësisë së shëndetshme <input type="checkbox"/> Aksidentet në punë <input type="checkbox"/> Përqindja e njerëzve që jetojnë nen minimumin jetik	Drejtoritë përgjegjëse në qarqe	<input type="checkbox"/> Vitet e jetegjatësisë së shëndetshme <input type="checkbox"/> Aksidentet në punë <input type="checkbox"/> Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Cdo vit	
3	Toka	<input type="checkbox"/> Përqindja e tokës së degraduar <input type="checkbox"/> Sasitë e mbetjeve të eliminuara ne landfille <input type="checkbox"/> Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali <input type="checkbox"/> % e ricikluar (leter,plastik,qelq	Drejtorite përgjegjëse në qarqe Strukturat e Menaxhimit të Lëndfilleve	Përqindja e tokës së degraduar <input type="checkbox"/> Sasitë e mbetjeve të depozituara në landfille <input type="checkbox"/> Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali <input type="checkbox"/> % e ricikluar (leter,plastik, qelq,,	Cdo vit	

		mbetje bashkiake të bio degradueshme,)		mbetje bashkiake të bio degradueshme)		
4	Uji	<input type="checkbox"/> Cilësia e ujërave sipërfaqësore <input type="checkbox"/> Cilësia e ujërave nëntokësore <input type="checkbox"/> Përdorimi i ujit nga sektori <input type="checkbox"/> Përqindja e riciklimit të ujit <input type="checkbox"/> Përqindja e popullsisë së lidhur me shërbimin e trajtimit të ujerave të ndotur <input type="checkbox"/> Uji i Detit: Cilësia e ujit të bregdetit	Drejtorite përgjegjëse në qarqe Strukturat e menaxhimit të ITUN ⁵ -ve Ministria e Mjedisit	<input type="checkbox"/> Total N, total P, BOD-et, COD, SS, TDS, pH, percjellshmeria, etj. <input type="checkbox"/> pH, percjellshmeri, fortësia, kloridet, sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet, detergjentet, ngarkesa toksike e mikrobiologjike, etj. <input type="checkbox"/> Parametrat mikrobiologjike për ujin e bregdetit	Kampionim dhe matje sipas miratimit të kushteve mjedisore për cdo ITUN. Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore Programi i Monitorimit të cilësisë së ujit të bregdetit në plazhe	Sipas Ligjit nr. 34/2013 që amendon Ligjin nr 9115, date 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" Ligji nr. 9915, datë 12.05.2008 "Për Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me uje dhe largimin e ujerave të ndotura". Direktiva 2006/7/EC për menaxhimin e cilësisë së e ujërave të larjës
5	Ajri	<input type="checkbox"/> Ditët kur tejkalohe normat e cilesise së ajrit ⁶ <input type="checkbox"/> Shkarkimet sipas Burimit	Ministria e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO	Cdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur
6	Faktorët klimatike	<input type="checkbox"/> Shkarkimet e Gazeve Sere <input type="checkbox"/> shkarkimet sipas burimit (%) <input type="checkbox"/> Zhvillimi i kerkeses për energji <input type="checkbox"/> Alokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit <input type="checkbox"/> Përqindja e BËR (%) ⁷	Ministria e Mjedisit Ministria e Mjedisit Drejtorite përgjegjëse në qarqe	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO Përqindja e Energjisë nga BER (%) Numri i automjeteve të udhëtarëve	Cdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur

		<input type="checkbox"/> Evoluimi i numrit te automjeteve të udhëtarëve				
7	Asetët ë prëkshmë – Trashëgimia kulturore (perfshire trashëgiminë arkitektonike dhe arkeologjike) – Peisazhi	<input type="checkbox"/> Numri i godinave të ruajtura që restaurohen <input type="checkbox"/> Numri i vizitoreve <input type="checkbox"/> Gjëlberim urban per frymë	Drejtorite përgjegjëse në qarqe	<input type="checkbox"/> Numri i godinave të ruajtura që restaurohen <input type="checkbox"/> Numri i vizitoreve <input type="checkbox"/> Gjëlberim urban per fryme	Cdo vit	

1.1.1.2 Karakteristikat baze të indikatorit

Indikatorët Mjedisore janë mjete për vlerësimin e tendencave mjedisore të një zone, vendi apo rajoni, për matjen e progresit kundrejt objektivave të vendosur nga legjislativi vendas apo marrëveshje ndërkombëtare në tregues të caktuar, për vlerësimin e efektivitetit të politikave mjedisore të një vendi dhe shërbejnë gjithashtu për të komunikuar në mënyrë të thjeshtë rreth fenomeneve komplekse me audiencë me formim jo teknik.

Që të kualifikohet si i tillë një indikator si rregull duhet të jetë relevant për politikën mjedisore dhe i dobishëm për përdoruesit, të ketë kuptim nga ana analitike, të jetë i matshëm

Objektivi afatgjatë i shtetit shqiptar është mbulimi me monitorim i të gjithë indikatorëve të rekomanduar nga Agjencia Europiane e Mjedisit. Ndërtimi i Skedës Teknike të çdo indikatorit është hapi i parë në procesin e monitorimit të indikatorit si dokumenti që harton karakteristikat bazë të indikatorit për tu përpunuar me pas nga shkencëtarët e fushës.

Secili indikator është dhënë në një fletë teknike (TS) që ndjek modelin e formatit të indikatorit të AEM-së 2014) duke iu referuar ndonjë dokumenti teknik/metodologjik. Fleta teknike në veçanti përmban: Identifikimin (titull; kod) dhe klasifikimin (DPSIR; tipologjinë; AEM (temat), Racionalen — justifikimin për zgjedhjen e indikatorit; referencën shkencore, përkufizimin; njësitë, Kuadrin e politikës dhe objektivat, dokumentet përkatëse të politikës (me një vlerësim fizibiliteti të zhvillimit kombëtar), Metodologjia — metodologjia për llogaritjen e indikatorit; metodologjia për plotësimin e hendekut; referencat e metodologjisë², përgjegjësia dhe pronësia, si edhe pasiguritë.

Skeda Teknike e çdo Indikatorit

Ndryshimi klimatik (adaptimi dhe zbutja)

Seti i ndryshimit klimatik përfshin indikatorët që lidhen si me politikën e adaptimit (CCA) dhe ato të zbutjes (CCM).

Në këtë skemë janë inkuorporuar gjithashtu një numër indikatorësh të cilët fillimisht janë përdorur në topologjinë e AEM-së si kategori të veçanta tematike si energjia dhe transporti. Kjo tërheqje është e nevojshme ndërsa specializimi dhe zbatimi i politikave kombëtare në këto fusha nuk janë zhvilluar në atë nivel të cilat mund të lejojnë së pari një monitorim të veçantë dhe së dyti mekanizma eficient që do të prodhojnë të dhëna të përballueshme. Krahas ndryshimeve klimatike, transporti dhe konsumi i energjisë janë të lidhura me presione dhe impakte të tjera mjedisore si zhurma, ndotja e ujit dhe ajrit, fragmenti i ekosistemit etj. Monitorimi i këtyre efekteve është inkuorporuar gjithashtu në temat e lidhura (cilësia e ajrit, cilësia e ujit, biodiversiteti etj.)

Ndërsa ndryshimet klimatike mund të ndikojnë shumë parametra mjedisore dhe indikator tematik, të përgjithshëm të listuar në gjendjen ose presionin e parametrave klimatik (p.sh. të dhënat meteorologjike) duhet të merren gjithashtu në konsideratë për vlerësimin e gjithë politikave përkatëse tematike. (p.sh. ujërat, biodiversiteti).

² Përshkrimi metodologjik do të japë shpjegime të thjeshta në rastin kur ka dokumente të përshtatshme teknike. Pjesa më e madhe e referencave teknike gjenden te faqja zyrtare e AEM-s.

Emërtimi i indikatorit: Temperatura mesatare e ajrit	
Klasifikimi	Gjendja
Përkufizimi dhe Arsyeimi	
<p>Temperatura është një nga kushtet klimatike me të rëndësishme. Ajo dallohet lehtësisht nga publiku dhe është e thjeshtë për t'u matur. Temperatura mesatare i referohet një shkalle kohore specifike (çdo orë, ditore, mujore).</p> <p>Trendi i përkohshëm i ndryshimit të temperaturës mesatare mujore në një vendndodhje të caktuar është tregues i intensitetit të ngrohjes globale në këtë vend. Përderisa klima përcaktohet nga shumë faktorë, tensioni (dhe impakti) i ngrohjes globale nuk janë uniforme dhe indikator i duhet të monitorohet në vendndodhje të ndryshme. Përveç lidhjes me ndryshimet klimatike, temperatura mesatare e ajrit mund të japi informacion që ndihmojnë në interpretimin e fenomeneve dhe proceseve të tjera fizike.</p>	
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIMI KLIMATIK (A)
Metodologjia	
Stacionet Automatikë Meteorologjike ofrojnë matje të vazhdueshme, regjistruar të të dhënave dhe lidhje telekomunikimi të cilat sigurojnë një regjistrim automatik të dhënash.	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi
Ditë/natë, Ditore, mujore	Në të gjithë vendin – rrjeti i stacioneve në qendrat urbane dhe zonat rurale.
Indikatorë shtesë të cilët mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:	
<p>Valët e të nxehtit (AEM CSI): Numri i netëve të kombinuara tropikale (>20°) dhe ditëve të nxehta (>35°) në vit (I).</p> <p>Ky indikator tregon impaktin e ndryshimeve klimatike në kushtet e jetesës. (sidomos në qendrat urbane)</p>	
Autoriteti përgjegjës	Shërbimi meteorologjik i ushtrisë ka një rrjet funksional stacionesh.

Emërtimi i indikatorit:		Niveli i detit	
Klasifikimi	Gjendja		
Përkufizimi dhe Arsytimi			
<p>Niveli i detit është një indikator i rëndësishëm i ndryshimit klimatik sepse është i lidhur me impakte potenciale të rëndësishme mbi vendbanimet, infrastrukturën, njerëzit dhe sistemet natyrore. Ky indikator vepron në kohë shumë më tepër sesa ata indikatorë të cilët lidhen ngushtësisht me ndryshimet e temperaturave pranë sipërfaqes. Edhe nëse përqendrimi i gazit me efekt serrë do të stabilizohej menjëherë, niveli i detit do të vazhdonte të rritej.</p>			
Konteksti i politikës dhe Objektivat		NDRYSHIMI KLIMATIK (A)	
Metodologjia			
<p>Ndryshimet e nivelit të detit maten në mënyrë manuale duke përdorur matjen e baticës ose me pajisje GPS me ndjeshmëri të lartë dhe në distancë nga hapësira duke përdorur altimetrat.</p>			
Frekuenca e matjeve		Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Stinore (dimër/verë)		Zona bregdetare	
Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:			
Autoriteti përgjegjës		AKM. Të dhënat mund të sigurohen nga AEM e cila monitoron të gjithë territorin Evropian.	
Pasiguritë		Ndryshimet në nivelin mesatar global të detit rezultojnë nga një kombinim i disa proceseve fizike. Ndryshimet në densitetin e ujit nuk pritet të jenë uniforme në hapësirë, dhe ndryshimet në qarkullimin në oqean kanë impakte rajonale të ndryshme. Në ndonjë vendndodhje të caktuar mund të ketë lëvizje vertikale të tokës për shembull për shkak të ekstraktimeve lokale nëntokësore.	

Emërtimi i indikatorit:		Sasia e reshjeve atmosferike
Klasifikimi	Gjendja	
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Nivelet vjetore dhe stinore të reshjeve përbejnë një tjetër facta vendimtar për kushtet klimatike dhe ekologjike. Reshjet përcaktojnë ciklin ujor në një territor të caktuar. Influenca klimatike e reshjeve nuk lidhet aq shumë me sasinë absolute të reshjeve sesa me shpërndarjen e tyre kronologjike.</p> <p>Përveç lidhjes së ndryshimeve klimatike, reshjet japin informacion lidhur me interpretimin e fenomeneve dhe proceseve të tjera fizike.</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIMI KLIMATIK (A)	
Metodologjia		
<p>Stacionet automatike meteorologjike sigurojnë matje të vazhdueshme, regjistruarit e të dhënave dhe lidhjet e telekomunikimit mund të sigurojnë regjistrim automatik të të dhënave.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik– zhvillimi	
Matje të vazhdueshme. Grumbullimi i të dhënave në nivel mujor dhe vjetor kërkohet për qëllim krahasimi.	I gjithë vendi – rrjeti i stacioneve, ndarje në llojet e zonave sipas lartësisë.	
Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i reshjeve (mm³/orë) është monitoruar gjithashtu për të përcaktuar ngjarjet vjetore të reshjeve. (AEM CSI -I) • Numri i ditëve në muaj është një indikator i vlefshëm për të identifikuar stinët e thata (S) 		
Autoriteti përgjegjës:	Shërbimi metodologjik i ushtrisë ka një rrjet funksional stacionesh.	
Pasiguritë	Asnjë	

Emërtimi i indikatorit:		Erozioni i tokës
Klasifikimi	Gjendja	
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Erozioni i tokës nga uji ka efekte të konsiderueshme "brenda territorit" dhe "jashtë territorit". Duke hequr shtresën e punueshme pjellore, erozioni zvogëlon produktivitetin e tokës, dhe atje ku toka është e cekët mund të shkaktojë humbjen e gjithë trupit të tokës. Largimi i trupit të tokës, për shembull gjatë një stuhie të fuqishme, do të shkaktojë rrjedhje balte të cilat do të grumbullohen në zonat e gërryera, ndërsa në raste me serioze mund të bllokojnë rrugët, kanalet e kullimit dhe përmbysë godinat. Erozioni mund të sjellë kufizime në përdorimin e tokës dhe vlerës së saj, dëmtim të infrastrukturës, ndotje të ujërave, dhe efekte negative mbi habitatet dhe biodiversitetin.</p> <p>Ndryshimi klimatik mund të influencojë proceset e erozionit të tokës, shkaktuar kryesisht nga reshje ekstreme dhe thatësira. Ujëra të tepërta për shkak të shirave intensive dhe për një kohë të gjatë mund t'i shkaktojnë dëme të mëdha tokës si larje të shtresave, madje edhe rrëshqitje tokë. Megjithatë, nëse toka menaxhohet mirë, rezistenca ndaj erozionit prej ujit dhe/ose erës mund të përmirësohet ndjeshëm.</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIMI KLIMATIK	
Metodologjia		
<p>Parashikimet e erozionit bazohen në studimet e modelimit. Shumica e modeleve kanë një faktor të erozionit nga reshjet dhe të erozionit të tokës i cili reflekton kushtet mesatare të reshjeve. Vlerat tipike për këto faktorë mund të përfaqësojnë në mënyrë jo adekuate impaktin e shirave ekstrem.</p> <p>AEM është duke llogaritur indikatorin për gjithë Evropën duke përdorur (Bosco et al. 2014) një model makroskopik të erozionit të tokës në shkallë kontinenti.</p> <p>Modelet për monitorimin e zonave më të vogla (basenet e lumenjve) janë gjithashtu të disponueshme. Modeli G2 (JRC 2014, Panagos et al. 2014) përdor gjithashtu imazhet satelitore – teknologjitë GIS. Aplikimi i modelit G2 është testuar tashmë në Shqipëri (ujëndarëset Ishmi-Erzeni (2200 km²) – masa Pixel : 300 m, mbulim i përkohshëm: 2011-2012).</p> <p>Formula G2 është:</p> $E=(R/V)*S*(T/I)$ <p>ku:E: erozion (t ha⁻¹)</p> <p>R: eroziviteti i reshjeve (formulat origjinale USLE ose alternativat e përgatitura nga stacionet referente) (MJ mm ha⁻¹ h⁻¹) V: mbajtja e vegjetacionit (e përgatitur nga G2 duke përdorur të dhënat Biopar ose ekuivalent dhe përdorimi i tokës/i të dhënave të menaxhimit, p.sh. CORINE) (pa dimensione; V>=1) S: erodibiliteti i tokës (formulat origjinale USLE ose të modifikuar USLE nga JRC, 2012) (t ha h MJ⁻¹ ha⁻¹ mm⁻¹)</p> <p>T: influencë topografike (modifikimet USLE, 1996; zbatim strikt i kushteve USLE) (dpa dimensione; T>0)</p> <p>I: shpat ndarës (e përgatitur duke përdorur të dhënat satelitore G2 ; e korrigjuar në T; pjesërisht analoge me P te USLE) (pa dimension; 1 =< I=<2)</p>		

G2 përdor të dhënat standard të harmonizuara nga bazat e të dhënave Evropiane dhe globale, si baza e të dhënave të tokës LUCAS, baza e të dhënave Evropiane e tokës (ESDB), Shtresë e punueshme organike (TOC), produktet e geoland2 BioPar, Imazhe 2006, CORINE LC, Landsat TM, seti i të dhënave ASTER DEM, dhe baza të dhënash të mëdha publike. Si një model i orientuar nga të dhënat, shkalla hartografike e zbatimit G2 vendoset nga zgjidhja hapësinore e të dhënave të përdorura.

Frekuenca e matjeve

Mbulimi gjeografik – zhvillimi

Çdo 4 deri 8 vjet

Gjithë vendi

Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti primar i të dhënave:

Impakti i erozionit bregdetar në tokat e mbrojtura, mund të përdoret për të monitoruar presionet e ndryshimeve klimatike mbi biodiversitetin.

Autoriteti përgjegjës

Shërbimi gjeologjik

Emërtimi i indikatorit		Niveli i ujërave nëntokësore
Klasifikimi	Gjendja, impakti	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Niveli i ujërave nëntokësore tregon lidhur me gjendjen e depozitave të ujit dhe gjendjen e akuifereve (S) dhe qëndrueshmërinë e përdorimeve të ujit. (I). Ulja e shpejtë ose e vazhdueshme mund të çojë në humbjen e nivelit të produktivitetit të tokës, shkretëtirëzimin, erozionin dhe ndikime të tjera.</p> <p>Të dhënat që i referohen ujërave nëntokësore dhe organeve të ujit janë pjesë e bazës së të dhënave për ujin të AEM-së e cila përmban të dhënat e ofruara në kohë, të besueshme dhe relevante me politikën të mbledhura nga vendet anëtare të AEM nëpërmjet mbledhjes së të dhënave WISE-SoE.</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIME KLIMATIKE (A) / UJËRAT	
Metodologji		
Matjet janë automatike dhe përdorin gausmetër kontakti (portativ ose statik).		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Sezonale (2 deri në 4 matje vjetore në të njëjtën zonë janë të mjaftueshme)	Në mënyrë ideale duhet të jenë disa vende në çdo pellg ujëmbledhës.	
Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
-		
Autoriteti përgjegjës	Shërbimi gjeologjik	
Pasiguritë		

Emërtimi i indikatorit:		Shkarkimet e gazit me efekt serrë nga transporti
Klasifikimi	Trysnia	CSI 010/CLIM 050
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Ky indikator analizon tendencën afatgjatë në shkarkimet e gazit me efekt serrë nga transporti. Ky synon të vlerësojë tendencën e shkarkimeve nga transporti dhe të analizojë rëndësinë relative të gazeve të ndryshme me efekt serrë dhe kontributet nga secila mënyrë transporti.</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIMET KLIMATIKE (M)	
Metodologjia		
<p>Dorëzimi i të dhënave zyrtare është bërë të mekanizmat e Monitorimit të KKKBNK dhe AEM. Hartimi i shkarkimeve bazohet në një kombinim të të dhënave të aktiviteteve sektoriale, vlerave kalorifike dhe faktorëve të shkarkimeve të karbonit. Metodologjitë e rekomanduara për parashikimin e të dhënave të shkarkimeve përgatiten bazuar në Udhëzimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike për Inventarët Kombëtarë të gazeve me efekt serrë, e plotësuar dhe ndihmuar nga "Udhëzuesi për praktikat më të mira për inventarët kombëtarë të gazeve me efekt serrë" dhe udhëzimet e KKKBNK-së.</p> <p>Shkarkimet totale të gazit me efekt serrë nga transporti, përfshijnë CO₂, CH₄ dhe N₂O dhe analizohen nën këtë indikator. Shkarkimet janë ndarë në ato të transportit rrugor, transportit hekurudhor, lundrimi, aviacioni i brendshëm dhe transporti detar. Në përputhje me rregullat e KKKBNK, vlerat potenciale të ngrohjes globale të përdorura në këtë indikator janë marrë nga IPCC AR4, për periudhën pas vitit 2015. Të dhënat janë peshuar sipas potencialeve të ngrohjes globale të dhëna në vazhdim për secilin gaz me efekt serrë, për të dhënë një shkarkim total në milionë tonë CO₂ ekuivalent (MtCO₂e): CO₂ = 1, CH₄ = 25, N₂O = 298.r.</p> <p>Për transportin e pasagjerëve, shkarkimet specifike llogariten duke pjesëtuar shkarkimet CO₂ për secilin lloj transporti (p.sh. rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror) sipas numrit respektiv të pasagjerëve dhe kilometrave.</p> <p>Për transportin e mallrave, shkarkimet specifike llogariten duke pjesëtuar shkarkimet CO₂ për secilin lloj transporti (p.sh. rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror) sipas numrit respektiv të pasagjerëve dhe kilometrave.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Në kushtet aktuale, detyrimi i komunikimit kombëtar të KKKBNK është çdo katër vjet. Mekanizmi i monitorimit të AEM mbledh të dhëna vjetore.	Gjithë vendi	
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti primar i të dhënave:		
Autoriteti përgjegjës	AKM nga të dhënat të cilat janë në dispozicion të Ministrisë së Transporteve/ INSTAT dhe Ministrisë së Tregtisë (transport mallrash, konsumi i karburantit, ngarkesa e transportit etj.).	
Pasiguritë	Indikatori vlerësohet nga të dhënat statistikore të lëvizjeve dhe tregtisë. Cilësia e këtyre të dhënave është thelbësore për besueshmërinë e vlerësimeve.	

Emërtimi i indikatorit:		Inventari i shkarkimeve të GES në 5 sektorë bazë (Energji, tretësit, proceset industriale, bujqësia, mbetjet)
Klasifikimi	Trysnia	KKKBNK
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Me qëllim parandalimin e impakteve më kritikë të ndryshimeve klimatike, shtetet (të cilave iu referohet si “Palë”) të cilët kanë nënshkruar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), kanë rënë dakord të bashkëpunojnë me qëllimin e kufizimit të rritjes së temperaturës mesatare globale dhe rezultateve në ndryshimet klimat. Në këtë kontekst, vendet mund të duhet që në mënyrë periodike (sipas statusit të zhvillimit industrial) të përgatisin dhe dorëzojnë inventarë të sakta dhe të rregullta të përditësuara të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES).</p> <p>Indikatori jep informacion lidhur me shkarkimet nga burimet kryesore antropogjenike të GES, të shpërndara nga sektorët kryesorë të shkarkimit, sipas nomenklaturës së IPCC.</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIMET KLIMATIKE (M)	
Metodologjia		
<p>Dorëzimi i të dhënave zyrtare bëhet të mekanizmi i Monitorimit të KKKBNK AEM. Përgatitja e shkarkimeve bazohet në një kombinim të faktorëve të të dhënave të aktivitetit sektorial, vlerave kalorifike dhe shkarkimeve të karbonit. Metodologjitë e rekomanduara për parashikimin e të dhënave të shkarkimeve përgatiten bazuar në Udhëzimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike për Inventarët Kombëtarë të gazeve me efekt serrë, e plotësuar dhe ndihmuar nga "Udhëzuesi për praktikatat më të mira për inventarët kombëtarë të gazeve me efekt serrë" dhe udhëzimet e KKKBNK-së.</p> <p>AEM ofron udhëzime të specializuara teknike për përgatitjen e inventarëve të shkarkimeve.</p> <p>Inventari i EMEP/AEM për shkarkimet nga ndotësit e ajrit është strukturuar sipas Nomenklaturës për raportim (NFR) e cila është përgatitur për herë të parë në vitin 2001-2002 nga Konventa TFEIP, më tej është përmirësuar në vitin 2006-2007, dhe është rishikuar përsëri në vitin 2013</p> <p>si pjesë e rishikimit të Udhëzimeve për Raportimin e të Dhënave të Shkarkimit sipas Konventës së ndotjes ndërkufitare të Ajrit në afat të gjatë (në vazhdim i referohet si LRTAP udhëzime të raportimit).</p> <p>Metoda më e zakonshme e vlerësimit është kombinimi i informacionit në atë nivel në të cilin aktiviteti njerëzor ndodh (e quajtur të dhëna të aktivitetit ose AD) me koeficientë me të cilët përcaktohet sasia e shkarkimeve ose largimeve për njësi aktiviteti, që quhen faktorët e shkarkimit (EF). Ekuacioni bazë këtu është:</p> <p>Shkarkimet = AD x EF</p> <p>Metodat e thjeshta (Radha 1) janë dhënë për të gjithë burimet dhe substancat, për të cilat vendet që kanë ratifikuar protokollet e Konventës, duhet të raportojnë. Metodat më të avancuara (Radha 2) janë dhënë për kategoritë kyçe. Për metodat e avancuara jepet informacion i mëtejshme (Radha 3) për kategoritë kryesore ku metodat e përshtatshme janë në dispozicion.</p> <p>Shkarkimet e gazit me efekt serrë shprehen në “milion tonë CO₂-ekuivalent” (Mt CO₂-eq.)</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Aktualisht detyrimi i komunikimit kombëtar tek KKKBNK është çdo katër vjet.	Gjithë vendi	
Mekanizmi i monitorimit të AEM-së mbledh të		

dhëna vjetore.	
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:	
Tendencat e shkarkimeve të gazit me efekt serrë (CSI010): indikatori tregon shkarkimet e të shkuarës dhe ato të parashikuara të GES-së në sektorët ETS dhe jo ETS, në përputhje me skemën ligjore të BE-së	
Autoriteti përgjegjës	Të dhënat e aktivitetit janë në dispozicion të ministrive të secilit sektor dhe INSTAT-it. AKM mban përgjegjësi për vlefshmërinë e llogaritjeve.
Pasiguritë	Cilësia e këtyre të dhënave është e rëndësishme për besueshmërinë e përgjithshme të parashikimeve.

Emërtimi i indikatorit:		Inventari i shkarkimeve të GES të përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pyjeve (LULUCF)
Klasifikimi	Trysnia	KKKBNK
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Inventari LULUCF parashikohet si shkarkimet dhe largimet e GES që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe pyjeve. Ky inventar mbulon shkarkimet dhe largimet antropogjenike të GES që rezultojnë nga stoqet e karbonit tokësor. Ai mbulon pishinat e karbonit me biomasë të gjallë (mbi dhe nën nivelin e tokës), substancat organike jo të gjalla (dru dhe mbeturina) dhe karbon organik për kategori të caktuara të tokës (tokën e pyjeve, tokë bujqësore, tokë me bar, ligatina, tokë urbane dhe të tjera)</p>		
Konteksti politik dhe Objektivat	NDRYSHIME KLIMATIKE (M)	
Metodologjia		
<p>Llogaritja LULUCF kryesisht bazohet në modelim. Modele dhe metoda të ndryshme janë përdorur në nivel BE gjatë 20 viteve të fundit. (GLOBIOM, G4M, CAPRI).</p> <p>Llogaritjet në gjithë metodat janë duke përdorur si variabël kryesor mbulesën e tokës (CORINE) dhe të dhënat statistikore që i referohen tokës bujqësore, tokës së gjelbër, numrit të bagëtive, sasisë së prodhimit, sasisë së kërkesës, çmimeve fillestare. Shkarkimeve nga aktivitetet në pyje përfshihen gjithashtu në llogaritjen e biomasës nga pyllëzimet dhe shpyllëzimet, menaxhimi i pyjeve (toka pyjore mbetet tokë pyjore) dhe shkarkimet nga produktet e drurit të prerë.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Në kushtet aktuale, detyrimi i komunikimit kombëtar të KKKBNK është çdo katër vjet. Mekanizmi i monitorimit të AEM mbledh të dhëna vjetore	Gjithë vendi	
Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	Të dhënat e aktivitetit janë në dispozicion të ministrive të secilit sektor dhe të INSTAT-it. CORINE sigurohet nga AEM çdo 6 vjet, duke mbuluar të gjithë kontinentin. AKM mban përgjegjësi për vlefshmërinë e llogaritjeve.	
Pasiguritë	Cilësia e këtyre të dhënave është thelbësore për besueshmërinë e përgjithshme të parashikimit.	

Emërtimi i indikatorit:		Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë Konsumi final i energjisë sipas sektorëve/Konsumi i energjisë primare nga karburantet
Klasifikimi	Përgjigje/Forca shtytëse	
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Pjesa e energjisë së rinovueshme në sasinë bruto finale të konsumit të energjisë identifikohet si një indikator kyç për të matur progresin nga strategjia Evropë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Indikatori mbështetet në burimet e energjisë së rinovueshme që përfshijnë fuqinë e erës, energjinë diellore (termale, fotovoltaike dhe e koncentruar), energjinë hidroelektrike, energjinë e baticës, energjinë gjeotermale, biomasën dhe pjesën e rinovueshme të mbeturinave.</p> <p>Përdorimi i energjisë së rinovueshme ka shumë përfitime potenciale, duke përfshirë një reduktim të shkarkimeve të gazit me efekt serrë, diversifikimi i furnizimit me energji dhe një varësi e reduktuar në tregjet fosile të karburantit) veçanërisht, naftë dhe gaz). Rritja e burimeve të energjisë së rinovueshme mund të këtë gjithashtu potencialin për të stimuluar punësimin, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës në teknologjitë e reja "të gjelbra".</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	NDRYSHIMET KLIMATIKE (M)	
Metodologjia		
<p>Pjesa e burimeve të energjisë së rinovueshme përkufizohet si raporti midis energjisë së prodhuar nga burime të energjisë së rinovueshme dhe konsumit kombëtar bruto. Energjia e prodhuar nga burimet e energjisë së rinovueshme përfshinë energjinë elektrike nga hidrocentralet (duke përjashtuar ato të pompimit), si edhe energjinë elektrike dhe nxehtësinë e prodhuar nga biomasa/mbetjet, era, instalimet diellore dhe gjeotermale.</p> <p>Pjesa e energjisë së rinovueshme në karburantin e konsumuar nga sektori i transportit llogaritet bazuar në statistikat e energjisë, sipas metodologjisë së përshkruar në Direktivën 2009/28/BE. Kontributi i të gjithë biokarburanteve përfshihet në llogaritjen për këtë indikator deri në vitin 2010. Duke filluar nga viti 2011 të dhënat për biokarburantet në transport janë kufizuar vetëm në biokarburantet në përputhje me Direktivën 2009/28/BE (pra me fjalë të tjera që plotëson kriterin e qëndrueshmërisë). (për analiza të mëtejshme shih Rregulloren 1099/2008 në lidhje me statistikat e energjisë)</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulim gjeografik – zhvillimi	
Çdo 3 vjet	Gjithë vendi	
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	AKM nga të dhënat e Autoritetit rregullator të energjisë/Ministrisë së Energjetikës	
Pasiguritë	Indikatori vlerësohet nga të dhënat statistikore të lëvizjeve dhe tregtisë. Cilësia e këtyre të dhënave është thelbësore për besueshmërinë e përgjithshme të vlerësimeve.	

Emërtimi i indikatorit		Efiçenca e energjisë (Shërbimi i transportit/, rezidencial, industria)
Klasifikimi	Përgjigjja	
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Politikat për promovimin e efiçencës së energjisë janë pjesë vitale e Strategjisë për Zbutjen e ndryshimeve klimatike. Efiçenca dhe konsumi i energjisë janë të lidhura në mënyrë thelbësore. Efiçenca më e madhe e energjisë mund të sjellë ulje të ndjeshme të konsumit të energjisë me kusht që të jenë marrë masa që shmangin shfaqjen e efekteve reaksion. Reduktimi i konsumit të energjisë si rezultat i progresit në rritjen e efiçencës së saj dhe ndryshimet në sjelljen ndaj energjisë mund të sjellin zvogëlime të ndjeshme të trysnisë mbi mjedis të lidhur me prodhimin dhe konsumin e energjisë. Efiçenca e energjisë mund të arrihet në mënyra të ndryshme, me përdorimin e teknologjive të reja, alternimin e burimeve të energjisë, bashkëprodhimi i energjisë për ngrohje. Në kontekstin e politikës së BE-së, monitorimi i performancës së efiçencës së energjisë është i lidhur me planet kombëtare të veprimeve për efiçencën e energjisë (EED 2012/27/BE)</p>		
Kuadri i politikave dhe Synimet	NDRYSHIME KLIMATIKE (M)	
Metodologjia		
<p>Në nivelin e BE-s, ODEX është përdorur me qëllim monitorimin e indikatorëve. Indeksi ODEX mat progresin e efiçencës së energjisë sipas sektorëve kryesorë (industri, transport dhe ekonomi familjare), si edhe për ekonominë si e tërë (gjithë konsumatorët e fundit). Për secilin sektor, indeksi llogaritet si një mesatare e ponderuar e indekseve nën sektoriale të progresit të efiçencës së energjisë; nën sektorët janë degët e sektorëve industrialë dhe të shërbimit ose përdoruesit e fundit të ekonomive familjare dhe transportit.</p>		
Frekuenca e matjes	Mbulimi gjeografik– zhvillimi	
Çdo 3 vjet	Gjithë vendi	
Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	AKM që merr të dhënat nga Ministria e Energjisë.	
Pasiguritë	Indikatorit vlerësohet nga të dhënat statistikore të lëvizjeve dhe tregtisë. Cilësia e këtyre të dhënave është thelbësore për besueshmërinë e përgjithshme të vlerësimeve.	

Ndotja e ajrit.

Indikatorët e përzgjedhur nuk kanë ndonjë diferencë të ndjeshme krahasuar me skemat ekzistuese të monitorimit. Monitorimi i ndotjes së ajrit ka qenë subjekti të cilit i është dhënë prioriteti më i madh në të shkuarën dhe për këtë arsye, objekti kryesor ka të bëjë me mbështetjen e zgjerimit dhe modernizimit të sistemit për të plotësuar standardet e reja. Futja e një indikatorit, impakti i të cilit kombinon elementet e sistemit të matjes me të dhënat e popullsisë të propozuara me qëllim prodhimin e evidencave për vendimmarrjen. Në afat të mesëm, krahas përgatitjes së indikatorëve të rrjetit të stacioneve matës lidhur me forcat shtytëse (transport, energji) dhe përgjigjet (cilësi e karburantit) mund të shtohen në varësi të përcaktimit të politikave kombëtare.

Emërtimi i indikatorit: Reshjet atmosferike (SO₂, NO_x, Pb)

Klasifikimi Gjendja

Përkufizimi dhe Arsyetimi

Përqendrimi i ndotësve në ujërat e shiut duke shkaktuar infektimin e ujërave të freskëta dhe dherave dhe tregon përveç të tjerave ndotjen transkombëtare.

Përqendrimi i këtyre ndotësve në ujin e shiut dhe reshjet shkaktojnë degradim të ujit dhe tokës. Si rezultat i lëvizjes së ndotësve nëpërmjet reve, indeksi i përdorur për vlerësimin e ndotjes ndërkufitare e rregulluar sipas Protokollit të Gotenburtit të Konventës për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe (konventa LRTAP).

Kuadri i politikave dhe Synimet NDOTJA E AJRIT

Metodologjia

Analizat kimike të kampioneve (spektrofometër)

Frekuenca e matjeve **Mbulimi gjeografik – zhvillimi**

Analizat e kampioneve të ujit të shiut (>5 mm) Një ose dy stacione

Indikatorë shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:

Autoriteti përgjegjës AKM

Pasiguri

Emërtimi i indikatorit: Shkarkimet e ndotësve urbanë të ajrit (PM, SO₂, NO_x, O₃, CO, HC)

Klasifikimi Trysnia

Përkufizimi dhe Arsytimi

Ndotësit fotokimikë janë burimi kryesor i ndotjes së ajrit në zonat urbane, të shkaktuara kryesisht nga transporti dhe prodhimi i energjisë.(ngrohja). Këta indikatorë janë përgatitur kryesisht për të dhënë informacion lidhur me performancën e reduktimit të shkarkimeve në ajër. Në kontekstin e BE-së, ato përshkruhen në Direktivën 2008/50/BE. Monitorimi ka të bëjë me regjistrimin e parametrave të mëposhtëm:

- Përqendrimi mesatar çdo orë/ditor/ vjetor (µg/m³)
- Numri mesatar i ditëve që kalojnë kufirin

Kuadri i politikave dhe Synimet NDOTJA E AJRIT

Metodologjia

Matja e ndotësve (infektuesve) duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24 orëve. Koha e përgjigjes së analizuesve automatike është në rendin e një minute, p.sh. çdo analist jep një vlerë pothuajse çdo minute. Me një mikroprocesor dhe/ose regjistruer i cili do të vendoset në çdo stacion të lidhur, analizuesit automatikë llogarisin në çdo kohë vlerën mesatare në orë për ndotjen.

Mikrogramet (mg) e ndotësve për metër kub për PM_{2.5}, PM₁₀, O₃, NO_x dhe SO₂.

Vlerat e mbledhura transferohen në serverin e bazës së të dhënave nga një modem, duke lejuar në këtë mënyrë regjistrimin e vazhdueshëm për nivelet e ndotjes së ajrit në një zonë urbane.

Në përgjithësi metodat e përdorura në stacionet automatike janë:

NDIR (CO), kimiluminishencë (NO_x), IR thithje (O₃), fluorometrik (SO₂), b rrezatim ose gravimetrik (PM), gaz kromatografi (HC).

Stacionet e monitorimit të mbikëqyrjes mund të përdoren gjithashtu për të regjistruar ndotjen e ajrit në më shumë zona për të siguruar të dhëna për të kuptuar më mirë modelet hapësinore të ndotjes (zona urbane më të vogla, pyje, zona rurale afër akseve të mëdha të transportit ose zonave industriale).

Frekuenca e matjeve

Vazhdueshëm në qytete, kampionime në "zona të kërkimit".

Afërsisht 110 stacione të monitorimit të mbikëqyrjes në vit duhet të mbulojnë 4 fushata të kampionimit.

Mbulimi gjeografik – zhvillimi

Qendrat e mëdha urbane/zona të tjera

Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:

- **Tejkalimi i vlerave limit të cilësisë së ajrit në zonat urbane**

Emërtimi i indikatorit:	Shkarkimi i ndotësve urbanë të ajrit (Metale të rënda (Pb,As,Mn,Ni,cu,Zn,Cd)	
Klasifikimi	Trysnia	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Metalet e rënda përthithen në PM dhe mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve nëpërmjet mbytjes. Në zonat rurale dhe natyrore, metalet e rënda mund të infektojnë gjithashtu edhe të mbjellat dhe burimet e tjera natyrore.</p> <p>Indikatorit jep informacion lidhur me prodhimin e energjisë dhe shpërndarjen; përdorimin e energjisë në industri; proceset industriale; transportin rrugor; transportin jo rrugor (veçanërisht duke iu referuar cilësisë së karburanteve) ; tregtar, institucional dhe të ekonomisë shtëpiake; përdorimi i tretësve dhe produkteve; bujqësia; mbetjet;</p> <p>Indikatorit lidhet me politikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Protokollin i Aarhusit për metalet e rënda 1998 (Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe e vitit 1979, Konventa UNECE (LRAP)), objektivi i tretë, veçanërisht për substancat e dëmshme : kadmium, merkuri dhe plumbi. - Direktiva e BE-së 2001/80/KE për kufizimin e shkarkimeve të ndotësve të caktuar në ajër, nga fabrika të mëdha të djegies (Direktiva LCP) synon të reduktojë shkarkimin e metaleve të rënda nëpërmjet kontrollit të pluhurit dhe thithjes së metaleve të rënda. - Direktiva e BE-së 2010/75/BE mbi shkarkimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) 		
Kuadri i politikave dhe Objektivat	NDOTJA E AJRIT	
Metodologjia		
<p>Përqendrimi i metaleve të rënda matet me PM, i cili mblidhet ose automatikisht (stacionet automatike, shih më lart), ose në mënyrë manuale nëpërmjet stacioneve gjysmë automatike ose tubave pasive.</p> <p>Tubat pasivë ose difuzivë përthithin ndotësit që janë ekspozuar dhe përdoren për mbledhjen e kampioneve. Testi i metalit të rëndë realizohet me kampionet PM10/PM2.5 nëpërmjet metodës së fluoreshencës së rrezatimit X me shpërndarjen e energjisë.</p> <p>Stacionet e monitorimit të mbikëqyrjes duhet të përdoren me qëllim regjistrimin e ndotjes së ajrit në zonat jo urbane, gjithashtu në (vendbanime të vogla, pyje, zona rurale pranë akseve kryesore të transportit dhe industrisë)</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Afërsisht 110 Stacione monitorimi në vit do të mbulojnë 4 fushata kampionimi	Stacionet e kampionimit duhet të mbulojnë të gjithë vendin	
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	Sot ekziston një përgjegjësi e përbashkët midis AKM dhe Institutit të Shëndetit Publik. Është propozuar unifikimi i përgjegjësisë nën një autoritet (AKM)	

Emërtimi i indikatorit:	Tejkalimi i vlerave limit të cilësisë së ajrit në zonat urbane	
Klasifikimi	Trysnia	CSI 004
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Telekomunikimi dhe përdorimi i energjisë i cili lidhet me aktivitetet e jetesës dhe ato ekonomike në zonat urbane me dendësi të lartë rezultojnë në rritje të shkarkimeve të ndotësve të ajrit, të cilat sjellin nga ana e tyre përqendrime të larta të këtyre ndotësve në mjedis dhe rritje të ekspozimit ndaj tyre.</p> <p>Racionalja për zgjedhjen e ndotësve dhe udhëzimeve të OBSH-së, për sa i përket efektit mbi shëndetin e njerëzve të ndotësve të ajrit (OBSH, 2013) arrihet në përfundimin se ekziston një informacion i ri shkencor lidhur me efektet negative mbi shëndetin nga grimcat (PM) e ozonit (O3) dhe dyoksidit të azotit (NO2), vërejtur në nivel zakonisht të pranueshëm në Evropë.</p>		
Konteksti i politikës dhe Objektivat	NDOTJA E AJRIT	
Metodologjia		
<p>Llogaritja e indikatorit bazohet në mbledhjen e të dhënave të njëjta nga skema e monitorimit. Stacionet në databazën e cilësisë së ajrit bashkohen në hapësirë me zonat urbane në një sistem të informacionit gjeografik me qëllim që të zgjedh këto stacione të cilat gjenden në kufijtë e qyteteve.</p> <p>Popullsia e qyteteve vlerësohet në 1 566 588 (2013) banorë dhe është përhapur në 10 qendra urbane³. Stacionet e përzgjedhura përmbajnë lloje stacionesh të klasifikuara si "trafik urban", "trafik periferik", "sfond urban" dhe "sfondi periferik". Stacionet e klasifikuara si "industriale" influencohen nga shkarkime të tjera lokale dhe këto ambiente zakonisht nuk përfaqësojnë zonat rezidenciale. Stacionet industriale prandaj nuk janë zgjedhur për llogaritjet e indikatorit. Përqindja e popullsisë urbane po përdoret për të shprehur rezultatin e indikatorit. Gjurmimi i indikatorit mund të bëhet për popullsinë e përgjithshme urbane dhe për çdo qendër urbane, me qëllim përshkrimin e diferencave hapësinore.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimi	
Monitorim i vazhdueshëm	10 qendra urbane	
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:		
-		
Autoriteti përgjegjës	AKM	
Pasiguritë	<p>Derisa stacionet e monitorimit mbulojnë sot 6 nga 10 qytete me stacione automatike, llogaritja e indikatorit duhet të rregullohet në zonën e mbuluar, derisa të prezantohen zona të reja.</p> <p>Cilësia e rezultateve varet nga densiteti i rrjetit të stacioneve.</p>	

³ Sipas klasifikimit EUROSTAT, qendra të vogla urbane përkufizohen ato me popullsi nga 50 000 në 100 000 banorë (Korçë 86 994, Fier 84 638, Kamëz 81 688, Berat 63 132, Lushnjë 53 507). Tirana (622 190), Durrës (203 917), Vlorë (135 032), Elbasan (124 179), Shkodër, (111 686) Qendra urbane mesatare

Emërtimi i indikatorit:	Nivelet e zhurmës
--------------------------------	--------------------------

Klasifikimi	Trysnia
--------------------	---------

Përkufizimi dhe Arsyetimi

Monitorimi i zhurmës i referohet niveleve të ekspozimit të popullsisë ndaj burimeve të zhurmës si transporti, ndërtimi dhe industria.

Parametra të veçantë të cilat vrojtohen në investigimet e zhurmës janë niveli ekuivalent i vazhdueshëm i zhurmës (L_{eq}), niveli maksimal i zhurmës (L_{max}) nivelet e 10% dhe 90% (L_{10} , L_{90}). Monitorimi i zhurmës mund të ndahet në matje/nivele të ditës dhe natës për shkak të rëndësisë që kanë kushtet e cilësisë së gjumit në shëndetin e njerëzve.

Megjithëse legjislacioni i BE-së nuk përcakton limite të ekspozimit ndaj zhurmave (KE 2002/49/KE), OBSH rekomandon që nivelet e zhurmës gjatë natës nuk duhet të jenë mbi 40 dB L_{night} me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Konteksti politik dhe Objektivat	Kushtet e mjedisit urban dhe të jetesës
---	---

Metodologjia

Matjet janë të lehta si rezultat i përdorimit të pajisjeve automatike portative. Krijimi i hartave të zhurmës lidhet me nivelet e zhurmës në zonat rezidenciale dhe me numrin e popullsisë së ekspozuar.

Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik –zhvillimi
Matje në çdo orë me bazë 24 orëshe për një numër të caktuar ditësh (14) Vlerat korresponduese të ditës dhe natës në ditë.	Qendrat urbane, zonat industriale pranë zonave urbane, nyjat e transportit që gjenden pranë zonave rezidenciale (aeroporte, autostrada, hekurudha dhe porte).
Vlerat mesatare dyjavore ditë dhe natë.	

Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:

Autoritetit përgjegjës	AKM
-------------------------------	-----

Pasiguritë

Uji dhe Deti. Indikatorët për ujin kryesisht të adaptuara për zbatimin e skemave WFD ekzistuese të monitorimit të integruar. Zbatimi efektiv (që përfshin edhe monitorimin) megjithatë, kërkon përgatitjen dhe zbatimin e planeve të Menaxhimit të Basenit të Lumit (RBMP) i cili do të përcaktojë me hollësi gjendjen aktuale dhe objektivat. Ndaj rregullimet e propozuara duhet të konsiderohen si një skemë monitorimi ndërmjetëse e cila do të finalizohet në RBPM. Indikatorët që lidhen me detin shqyrtohen veçmas. Dallimi bazohet në ekzistencën (aktuale) të një kuadri të veçantë të politikës për mjedisin detar (në lidhje dhe krahas WFD). Kjo kornizë është përcaktuar nga politika e Strategjisë Detare dhe është e specializuar në Strategjinë Rajonale Makro të Detit për zonën Adriatik - Jon (EUSAIR). Cilësia e mjedisit detar konsiderohet si një faktor vendimtar për perspektivat e "rritjes Blu" dhe zbatimi i axhendës së zhvillimit EUSAIR pritet të shfrytëzojë prospektet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare në Shqipëri. Indikatorët e peshkimit janë shtuar tek indikatorët e mjedisit detar.

Emërtimi i indikatorit:	<p>Kushtet fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore (Alkaliniteti, përcjellshmëria, aciditeti, COD / BOD₅, ushqyesit PO₄, NO₃ dhe NH₄, pH, ndotësit dhe substancat prioritare WFD)</p> <ul style="list-style-type: none"> – Substanca që konsumojnë oksigjen në lumenj (CSI 020), Ushqyes në ujëra të ëmbla (CS 020), Ushqyes në ujëra kalimtare, bregdetare dhe detare (CSI 021)
Klasifikimi	Gjendje - Trysnia
Përkufizimi dhe Arsytimi	<p>Indikatorët e ujit japin informacion lidhur me gjendjen dhe trysninë tek uji i freskët, ujërat kalimtare, bregdetare dhe detare. Monitorimi i ujit lidhet me tema të ndryshme për shkak të rëndësisë së cilësisë së ujit për jetën e njerëzve, mbrojtjen e biodiversitetit dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike. Nisur nga perspektiva evropiane, kjo fushë tematike është një fokus i zhvillimit të indikatorit me direktivat respektive, duke përfshirë WFD dhe direktivën 2008/56/BE.</p> <p>Aktivitetet antropogjenike me bazë tokën dhe ujin, të cilët mund të arrijnë në këtë mjedis në mënyrë direkte ose indirekte, mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit në rajonet kalimtare, bregdetare dhe detare. Ndotja më e madhe shkaktohet nga aktivitetet në tokë, përmes rrugëve ujore si përdorimi i plehrave kimike dhe blegtoaria, ose shkarkimi i ujërave të zeza të trajtuara keq ose aspak të trajtuara. Ndotja mund të jetë gjithashtu në ajër, nga shkarkimet, ndonëse kjo ka më shumë relevancë për ujërat detare, në det të hapur. Këto aktivitete mund të sjellin përqendrime në rritje të ushqyesve (kryesisht azot dhe fosfor) të cilat shkaktojnë eutrofikimin dhe një zinxhir efektsh të padëshirueshme.</p> <p>Zakonisht bëhet një dallim midis efekteve direkte dhe indirekte të pasurimit të ushqyesve. Efektet direkte përfshijnë përqendrimin e lartë të klorofilës në kolonat e ujit, si rezultat i rritjes së fitoplanktonit nga rritja e prodhimit parësor (referohu CSI023), dhe ndryshimet në përbërjen dhe funksionimin e specieve të ekosistemit) si raporti i zgjatimeve të diatomit (<i>diatom flagellate</i>), kalimet bentike në pelagjike, si edhe ngjarjet e lulëzimit të algave bezdisëse/toksike).</p> <p>Substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë të përcaktuar sipas Aneksit II të Direktivës 2008/105/KE duhet të monitorohen gjithashtu (çdo muaj nëse ekzistojnë).</p>

Kuadri i politikave dhe objektivat UJI	
Metodologjia	
<p>Parametrat hidrologjik dhe fiziko kimik p.sh. temperatura e ujit, pH, oksigjeni i tretur, përcjellshmëria maten në vend duke përdorur instrument portative në terren. Në të njëjtën kohë, kampionet e ujit mblidhen për të përcaktuar ushqyesit, substancat prioritare, ndotësit dhe substanca të tjera kimike. (Cd, Cu, Ni, Fe, Pb, Zn, Mn).</p> <p>Procedurat e kampionimit janë standardizuar sipas protokolleve ISO5667-X:20XX. Analizat laboratorike mund të përfshijnë filtrimin dhe fotometrinë, ose kromoatografinë Ion ose përdorime të tjera të metodave analitike kimike.</p>	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik - zhvillimet
<p>Kampionet duhet të merren në stacionet e monitorimit "të mbikëqyrjes", për t'u monitoruar një herë në katër vjet dhe stacionet e përfshira në monitorimin "operacional" duhet të monitorohen çdo vit.</p> <p>Parametrat e përgjithshëm fiziko kimik dhe ato hidrologjik (p.sh. norma e rrjedhës, norma e ujit) duhet të maten tre herë në vit.</p> <p>Analizat e ndotësve dhe substancave prioritare duhet të kryhen çdo 2 vjet.</p>	<p>Një rrjet kombëtar i monitorimit të ujit që përfshin: liqen, lum, stacione bregdetare dhe kalimtare.</p> <p>Numri i saktë duhet përcaktuar.</p>
Indikatorët shtesë që mund të prodhohen nga seti i të dhënave primare:	
<p>Një indikator i përbërë duhet të adoptohet për të siguruar informacion që kuptohet me lehtësi. Sipas WFD ky indikator është:</p> <p style="text-align: center;">"% e trupave ujore në gjendje të mire kimike dhe ekologjike"</p>	
Autoriteti përgjegjës	
Pasiguritë	

Emërtimi i indikatorit:	Kushtet biologjike dhe ekologjike të ujërave të brendshme (fitoplankton dhe zooplankton, klorofil, peshqit)	
Klasifikimi	S, P	CSI 023
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Cilësia e ujit në rajonet tranzicionale, bregdetare dhe detare mund të ndikohet negativisht nga veprimtaritë tokësore dhe ujore antropogjenike, produktet e të cilave mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti ose jo këtë mjedis. Pjesa më e madhe e ndotjes vjen nga veprimtaritë në tokë, nëpërmjet rrugëve ujore, si p.sh. Përdorimi i plehrave kimike bujqësore dhe blegtorisë, apo nga shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara. Megjithatë, ndotja mund të shkaktohet edhe nga faktorë ajrorë, ndonëse kjo do të ishte më relevante për ujërat e brendshme detare. Këto veprimtari mund të rezultojnë në rritje të koncentratit të nutrientëve (kryesisht të azotit dhe fosforit) (shih gjithashtu CSI 021 Nutrientët në ujërat tranzicionale, bregdetare dhe detare) që çojnë në eutrofizim dhe që shkaktojnë një zinxhir efektësh të padëshirueshme.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	Ujërat	
Metodologjia		
<p>Marrja e kampioneve për analiza biologjike zakonisht kryhet njëkohësisht me analizat për cilësinë kimike.</p> <p>Sipas WFD-së, analizat biologjike përqendrohen te këta parametra:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jovertebrorët bentikë të mëdhenj (metodologjia STAR-AQEM ose metoda ISO 7828, 1985) - Peshqit (elektropeshkimi, identifikimi dhe matjet biometrike). - Diatomat dhe makrofitet (ekuacioni i mesatares së ponderuar) <p>Vlerësimi i natyrës fizike dhe cilësisë së habitatit të stacionit ku merret kampionimi (RHS, QBR) do të bëhet një herë gjatë katër viteve të projektit. Karakteristikat e statusit ekologjik duhet të përcaktohen në nivel të trupave ujqor (jo në stacionin ku është marrë kampioni).</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
<p>Kampionet do të merren në stacionet e monitorimit të "survejancës" që do të monitorohen një herë në katër vjet dhe stacionet do të përfshihen në monitorimin "operacional" dhe ky monitorim duhet të jetë vjetor.</p> <p>Parametrat biologjike që do të monitorohen me frekuencë dy herë në vit në të gjitha stacionet janë jovertebrorët bentikë të mëdhenj dhe peshqit. Diatomat dhe makrofitet mund të monitorohen në nënstacione në periudha të</p>	<p>Një rrjet kombëtar për monitorimin e ujit të: liqeneve, lumenjve, ujërave bregdetare dhe stacionet transkombëtare. Mbetet për t'u përcaktuar numri i saktë.</p>	

ulëta dhe të larta drenazhimi dhe vetëm vitin hidrologjik të ulet krahas kësaj.

Indikatorë të tjerë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

Duhet të përcaktohet një indikator agregat me qëllim që të sigurohet një informacion që "përthypet" lehtë. Sipas WFD-së, ky tregues është:

"% e trupave ujore në gjendje të mirë kimiko-ekologjike"

Autoriteti përgjegjës

AKM

Pasiguritë

Emërtimi i indikatorit:	Intensiteti i shkarkimit bujqësor
--------------------------------	--

Klasifikimi

Trysnia

Përkufizimi dhe Arsytimi

Indikatori përdoret për të ilustruar ndarjen e rritjes ekonomike (vlera bruto e shtuar-GVA) nga impakti mjedisor (humbjet në nutrientë). Indikatori tregon përqindjen e ndryshimit në shkarkimin e nutrientëve nga bujqësia (shprehur si balanca e nutrientëve) bashkë me ndryshimin në vlerën bruto të shtuar (GVA) të industrisë bujqësore gjatë së njëjtës periudhë kohore (midis viteve 2000-2011). Ndarja absolute ndodh kur variabli relevant mjedisor është stabil ose në rënie, ndërsa forca shtytëse ekonomike vjen në rritje. Kemi të bëjmë me ndarje relative kur përqindja e rritjes së shkarkimit është pozitive, por më pak se përqindja e rritjes së GVA-së.

Për më tepër, indikatori ilustron intensitetin e shkarkimit të sektorit bujqësor, të shprehur si shuma e balancës së nutrientëve në bujqësi për njësi prodhimi të sektorit bujqësor (shprehur si një milionë euro të vlerës bruto të shtuar). Indikatori ilustron si intensitetin e shkarkimit të bazuar mbi totalin e GVA (ku përfshihen edhe subvencionet) dhe intensitetin e shkarkimit bazuar te GVA-ja, duke përjashtuar subvencionet.

Kuadri i politikave dhe synimet

Ujërat

Metodologjia

Intensiteti i shkarkimit shprehet në ton ndotësish për një milionë EURO (ose lek) të GVA-së.

Përlllogaritjet bazohen mbi të dhëna nga llogaritë kombëtare për përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve të Ministrisë së Bujqësisë dhe/ose INSTAT-it.

Frekuenca e matjeve

Vjetore

Mbulimi gjeografik – zhvillimet

Treguesi përlllogaritjet për të gjithë vendin.

Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

Autoriteti përgjegjës

Ministria e Bujqësisë

Pasiguritë

Përkufizimi dhe Arsyetimi

Pasojat e veprimtarive ekonomike për sa i takon cilësisë dhe sasisë së ujit janë analizuar në kuadrin e WFD në Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore. Kërkimet për sa i takon lidhjes midis statusit të ujit (cilësia dhe sasia), presioneve përkatëse dhe forcave të tyre shtytëse ekonomike sigurojnë një bazë të rëndësishme për vendimmarrje dhe prioritizim të masave për sa i takon masave për mbërritjen e objektivave të WFD. Për më tepër, mund të ndihmojë në përcaktimin nëse një shtytës i veçantë tërhiqet nga impakti mjedisor. Duhet të sigurohen indikatorë që janë të thjeshtë për t'u kuptuar, me qëllim që të jepen sinjale dhe të matet progresi për përmirësimin e efikasitetit të burimeve.

Shkarkimi i nutrientëve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura jep një indikacion të ndotjes potenciale të ujit. Veprimtaria njerëzore në këtë indikator përfaqësohet me numrin e popullatës.

Indikator i përdoret për të ilustruar intensitetin e shkarkimit të sektorit shtëpiak (sektori shtëpiak plus shërbimet) i shprehur si sasia e ndotësve të shkarkuar nga trajtimi i ujërave të ndotura/ose të shkarkuara pa trajtim, për banor, në vit. Për më tepër, indikator i tregon ndarjen e shkarkimit të nutrientëve (azotit dhe fosforit) dhe rritjes së popullatës.

Treguesi mund të përdoret, por nuk përputhet plotësisht me dispozitat e VKM-së (Aneksi I, "shkarkimet e lëngëta urbane"). Indikator i EEA e kufizon monitorimin e azotit dhe fosforit. VKM për monitorimin përfshin parametra të tjerë që i referohen Ph, COD/BOD₅, alkalinitetit, aciditetit, fenolit dhe metaleve të rënda. Këto parametra duhet të ruhen për monitorimin e impianteve të trajtimit dhe sistemeve përkatëse të ujërave të zeza dhe të integrohen si të dhëna për indikatorët e kushteve të UJIT.

Kuadri i politikave dhe synimet

UJËRAT

Metodologjia

Për ngarkesën e përgjithshme të shkarkimit përdoret formula e mëposhtme:

$$N_{\text{totshkarkuar}} = N_{\text{tot(coll.system)}} + N_{\text{tot(pa trajtim)}} + N_{\text{tot(IAS)}} + N_{\text{tot(primar)}} + N_{\text{tot(sekondar)}} + N_{\text{tot(terciar)}}$$

(më shumë informacion për raportet teknike EEA)

është një indikator teorik që përlllogaritet bazuar mbi të dhëna të planeve për trajtimin e ujërave (nëse ekziston trajtimi) dhe të dhënave për popullatën shumëzuar me koeficientët që lidhen me kushtet e jetesës dhe praktikën e konsumit. Kërkohet vlerësim në rang kombëtar për përcaktimin e koeficientëve. Stacionet e monitorimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura do të sigurojnë të dhënat për përlllogaritjet.

Frekuenca e matje

Çdo 5 vjet (ose sipas ecurisë së

Emërtimi i indikatorit: Kushtet kimike të ujërave sipërfaqësorë

Klasifikimi Gjendja - Trysnia WEU 001

Përkufizimi dhe Arsyetimi

Direktiva Kuadër për Ujin ka si qëllim të garantojnë një balancë midis abstrakteve dhe rimbushjeve të sasisë së ujit në sipërfaqe dhe konservimit të përbërjes kimike të trupave të ujërave nëntokësorë. Për më tepër, për të siguruar një status të mirë sasior të një trupi të ujërave nëntokësorë" ndryshime të drejtimit të rrjedhës që shkaktohen nga ndryshime të nivelit mund të ndodhin përkohësisht ose vazhdimisht në një zonë të kufizuar hapësinore, por këto ndryshime që nuk shkaktojnë ndërhyrje të ujërave të kripura ose ndërhyrje të tjera dhe nuk janë tregues i një trendi të qëndrueshëm dhe të evidentuar qartësisht nga pikëpamja antropogjenike në drejtimin e rrjedhës të mundshme për të shkaktuar ndërhyrje të tilla".

Indikatorin në WFD ka për qëllim monitorimin e statusit të trupave nënujore nga këto rreziqe kryesore:

- Futja e ujit të kripur si rezultat i mbishfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore përbën një shqetësim serioz për shumë akuifere.

(in)Filtrimi i nutrientëve dhe pesticideve nga produktet bujqësore dhe ujërat e zeza urbane dhe industriale.

Kuadri i politikave dhe synimet UJI

Metodologjia

Përcaktimi i kushteve kimike të një akuiferi po vlerësohet përmes analizave kimike të kampioneve. Karakterizimi i statusit është në përputhje me Direktivën për Nitratet (91/676/KEE) dhe Direktivën për Ujin e Pijshëm (98/83/KE).

Frekuenca e matjeve

Kampionet që do të merren në stacionet e monitorimit të "survejancës" do të monitorohen çdo katër vjet dhe ato në stacionet e monitorimit "operativ" duhet të monitorohen çdo vit.

Parametrat e përgjithshëm fiziko-kimikë dhe parametrat e përgjithshme hidrologjike (si p.sh. ritmi i rrjedhës, norma e ujit) duhet të maten me një frekuencë tre herë në vit.

Analiza e ndotësve dhe substancave prioritare çdo 2 vjet.

Mbulimi gjeografik – zhvillimet

Një rrjet kombëtar për monitorimin e ujit të: liqeneve, lumenjve, ujërave bregdetare dhe stacionet transkombëtare. Mbetet për t'u përcaktuar numri i saktë.

Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

Duhet të përcaktohet një indikator agregat për të garantuar një informacion që është i thjeshtë për t'u kuptuar. Sipas WFD ky indikator është:

"% e trupave ujore në gjendje të mirë kimike dhe status të mirë ekologjik"

Autoriteti përgjegjës Survejanca gjeologjike

Pasiguritë

Emërtimi i indikatorit:	Morfologjia bregdetare
Klasifikimi	Statusi
Përkufizimi dhe Arsyetimi	
Rëndësia e zonave bregdetare për ekonominë, ekologjinë dhe shoqërinë është shumë e madhe duke qenë se në zonat bregdetare është e përqendruar pjesa dërmuese e popullatës dhe aktivitetit ekonomikokulturor.	
Kuadri i politikave dhe synimet	NDRYSHIME KLIMATIKE
Metodologjia	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Çdo 4-8 vjet	Zonat bregdetare
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
Ndikimi i erozionit bregdetar mbi tokat e mbrojtura mund të përdoret për monitorimin e presioneve të ndryshimeve klimatike në biodiversitet	
Autoriteti përgjegjës	Shërbimi Gjeologjik
Emertimi i indikatorit	Cilësia e ujit që përdoret për tu lare (plazhe)
Klasifikimi	Statusi
Përkufizimi dhe Arsyetimi	
Cilësia e ujërave për larje është shumë e rëndësishme për parandalimin e rreziqeve që lidhen me higjienën. Indikatorin lidhet me turizmin e qëndrueshëm, duke qenë se ujërat e plazheve janë një burim me vlerë për turizmin. Cilësia e shkëlqyer e ujërave të plazheve përdoret rëndom për qëllime për nxitjen e zhvillimit të turizmit. Indikatorin mat kushtet mikrobiologjike që plotësojnë standardet për parametrat që janë pjesë e Direktivës së Re për ujërat për larje (2006/7/KE),	

<i>(enterokoku intestinal dhe Escherichia coli).</i>	
Kuadri i politikave dhe synimet	Ujërat
Metodologjia	
<p>Analiza e barrës mikrobiologjike të kampioneve dhe krahasimi i vlerave limit të direktivës. Rezultatet klasifikohen sipas këtyre kategorive: CI: Në përputhje me vlerat e detyrueshme të Direktivës për të pesë parametrat; CG: Në përputhje me vlerat e detyrueshme dhe vlerat më strikte udhëzuese të Direktivës për të pesë parametrat; NC: Nuk është në përputhje me vlerat e detyrueshme të Direktivës për të pesë parametrat; NF: Ujërat për larje për të cilat nuk janë marrë kampione të mjaftueshme (nuk plotësohen kriteret e shpeshtësisë); NS: Ujërat për larje për të cilat nuk janë marrë kampione për shkak të faktorëve të jashtëm; B: të ndaluara apo të mbyllura.</p>	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Çdo muaj gjatë gjithë periudhës së notit.	Zonat bregdetare dhe liqenet, së paku në 100 stacione.
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
"blue flags" është një program ndërkombëtar për monitorimin e ujërave për larje dhe cilësinë (dhe konformitetin) e plazheve.	
Autoriteti përgjegjës	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
Pasiguritë	

instalimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura)

Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

% e popullatës që mbulohet nga impiantet e trajtimit të menaxhimit të ujërave të ndotura

Autoriteti përgjegjës

Pasiguritë

Emërtimi i indikatorit:	Morfologjia bregdetare (rrjedha, zona, dinamika e grykëderdhjeve)
Klasifikimi	Statusi
Përkufizimi dhe Arsyetimi	
<p>Indikatorët e ujit që japin informacion mbi gjendjen dhe trysninë e ujërave të ëmbla, tranzicionale, bregdetare dhe detare. Monitorimi i ujit lidhet me disa tematika të tjera të ndryshme për shkak të rëndësisë së cilësisë së ujit, për shëndetin e njeriut, për ruajtjen e biodiversitetit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. Nga këndvështrimi evropian, kjo fushë tematike përbën një fokus të zhvillimit të indikatorit me direktivat përkatëse, duke përfshirë WFD dhe Direktivën 2008/56/KE. Zonat bregdetare janë vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike. Erozioni (tërheqja e</p>	

vijës bregdetare drejt tokës) mund të shkaktohet nga ngritja e nivelit të detit, humbja e volumit të ujit sipërfaqësor, shkretëtirëzimi dhe shpyllëzimi apo nga ndikimi i përmbytjeve ekstreme.

Kuadri i politikave dhe synimet

UJËRAT

Metodologjia

Përdorimi i imazheve satelitore dhe sistemit *Remote sensing* sigurojnë njohje optike të morfologjisë bregdetare. Në një shkallë më pak makroskopike, përdorimi i modeleve matematikore (Delft3D, MIKE21) që stimulojnë proceset fizike, kimike apo biologjike në zonat bregdetare apo detare (lëvizjet e dallgëve sezonale dhe përbërja e shtratit të detit) mund të sigurojnë të dhëna mbi përqindjen e erozionit bregdetar, në veçanti të segmenteve bregdetare.

Metodologjia analitike është përpunuar nga EUROSION PROJECT (2002),

Frekuenca e matjeve

Mbulimi gjeografik – zhvillimet

Në vazhdë për parametrat morfologjikë, rrjedha mund të monitorohet çdo 6 vjet, sipas WFD.

Së paku një pikë në çdo sistem. Idealja do të ishte të merrej kampion pas çdo lëvizjeje që ndryshon rrjedhën.

Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

Autoriteti përgjegjës

Shërbimi Gjeologjik

Pasiguritë

Emërtimi i indikatorit:		Substancat e rrezikshme në organizmat detare
Klasifikimi	Trysnia	
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Substancat e rrezikshme emetohen në ujërat e ëmbla dhe ato detare përmes një sërë rrugësh dhe mund të kenë ndikim negativ në biotën ujore. Njerëzit mund të ekspozohen ndaj substancave të rrezikshme në ujë përmes marrjes së ujit të pijshëm të kontaminuar dhe konsumit të peshkut të ujërave të ëmbla dhe frutave të detit të kontaminuara. Tashmë në Evropë ka një bazë të gjerë ligjore për trajtimin e çlirimit të substancave të rrezikshme në mjedis, duke përfshirë edhe ujërat detare.</p> <p>Megjithatë ka sfida të reja, duke përfshirë edhe aspekte të përzierjeve kimike dhe ndotësve të rinj.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	Ujërat	
Metodologjia		
<p>Përqendrimi i metaleve të rënda dhe i substancave organike mund të përcaktohet ose nga analiza e indeve të muskujve ose/dhe nga analiza kimike e sedimentit. Parametrat e monitorimit u referohen Cd, Hg, Pd, HCB, Lindane, DDT, RCB. Instrumentet e vlerësimit dhe modelimit ndihmojnë për lidhjen e kontaminimit kimik me përkeqësimin e vëzhguar të cilësia ekologjike e ekosistemeve ujore. Instrumente të tilla përfshijnë qasjet novatore për vlerësimin e të dhënave ekzistuese kimiko-biologjike, bashkë me teknikat eksperimentale specifike të kantierëve për të përcaktuar marrëdhëniet shkak-pasojë.</p> <p>EEA Raporti teknik nr.8/2011</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Çdo 2 vjet	<p>Ujërat bregdetare (deri në 40 metra thellësi), pikat ku merren kampionet duhet të mbulojnë së paku zonat kryesore të deltave lumore dhe zonat që preken nga shkarkimi i ujërave të ndotura urbane apo mbetjeve të lëngshme industriale. Monitorimi proaktiv duhet të mbulojë gjithashtu fushat e akuakulturës (sidomos midhjet)</p>	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)	
Pasiguritë		

Biodiversiteti (larmia biologjike)

Indikatorët e biodiversitetit janë të ndarë në dy kategori. I pari ka të bëjë me mbrojtjen e specieve dhe habitatit, tjetri me pyjet.

Duke u nisur nga i dyti, arsyeja për këtë ndarje ka të bëjë kryesisht me faktin sepse pasuria pyjore në Shqipëri ka një vlerë veçanërisht të lartë, qoftë si burim natyror, qoftë si burim zhvillimi. Pyjet dhe menaxhimi i tyre kanë një traditë të gjatë dhe lidhen me të ardhurat aktuale në zonat malore (që përfaqësojnë pjesën më të madhe të vendit). Për më tepër, monitorimi pyjor bazohet mbi një skemë panevropiane të një iniciative të një niveli të lartë me titull: FOREST EUROPE që ka për qëllim zhvillimin mbi baza vullnetare të strategjive midis pjesëmarrësve nga 46 vende dhe BE-ja.

Nga ana tjetër, menaxhimi dhe monitorimi i ekosistemeve dhe specieve natyrore është ende në zhvillim (zonat e propozuara të mbrojtura të vendit janë trefishuar gjatë dekadës së fundit). Miratimi i kuadrit evropian të menaxhimit dhe monitorimit në zonat e mbrojtura (duke përfshirë habitatet pyjore) kërkon elaborim të mëtejshëm. Duke pasur parasysh këto mangësi të regjistrimit dhe zhvillimit të politikave për biodiversitetin propozohet miratimi i indikatorëve që do të mbështesin proceset e qasjes që duhet të vijë duke u specializuar me qëllim që të plotësojë kërkesat e larta për monitorimin, sipas specifikimeve të nenit 17 të Direktivës për Habitatet.

Emërtimi i indikatorit:	Speciet /Habitatet me interes evropian
Klasifikimi	Statusi
Përkufizimi dhe Arsyetimi	
<p>Indikatori reflekton ndryshimet në statusin e konservimit të specieve me interes evropian. Ai bazohet aktualisht mbi të dhëna të mbledhura sipas detyrimeve për monitorim, sipas nenit 11 të Direktivës së BE-së për Habitatet (92/43/KEE). Indikatori reflekton drejtpërdrejt zbatimin dhe suksesin e Direktivës për Habitatet. Rrjedhimisht është tepër e rëndësishme për politikën e BE-së për konservimin/ruajtjen e natyrës. Rezultatet janë përfaqësuese për shtetet anëtare të BE-së dhe mund të agregohen në nivelin e BE-së.</p> <p>Shtetet duhet të monitorojnë dhe raportojnë mbi statusin e konservimit (CS) të specieve me interes evropian (Anekset II, IV, V të Direktivës). Statusi i konservimit ilustron në tri kategori semaforike (“<i>traffic light</i>”) (“I favorshëm” - jeshile, “I pafavorshëm/I pamjaftueshëm”- blu, “I pamjaftueshëm/I keq”- I kuq, plus i panjohur) të karakterizuara nga katër parametra:</p> <ul style="list-style-type: none"> tendencat dhe statusi i gamës, tendencat dhe statusi i popullatës në përgjithësi, cilësia dhe masa e habitatit, perspektiva e ardhshme. <p>Indikatori bazohet mbi një numër specimesh në tri kategoritë e para të CS dhe ndryshimeve kohore midis kategorive.</p>	
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI
Metodologjia	
<p>Zbatimi i plotë realist i detyrimeve për monitorimin e Direktivës për Habitatet nuk është një objektivi i arritshëm në periudhën afatmesme.</p> <p>Me qëllim që në të ardhmen të arrihet një nivel ku monitorimi i parametrave, si ndërveprimi, strukturat e ekosistemeve dhe funksionet është esenciale të zbatohet një program bazë monitorimi dhe survejance (sondazhi bazë) i cili do të sigurojë vlerat bazë për zhvillimet e ardhshme. Ky program do të përqendrohet te:</p> <ul style="list-style-type: none"> Shenjat kartografike të habitateve dhe territoreve të specieve (hartat e specieve prioritare). Regjistrimi i bio-komuniteteve dhe marrëdhënieve midis specieve Një vlerësim dy herë në vit i ndryshimeve. <p>Mbledhja e të dhënave do të kryhet kryesisht me anë të observimeve dhe punës kërkimore regjistruese. Një punë e plotë kërkimore për statusin aktual të konservimit (dhe hartat) për çdo klasë taksonomie/superklasë duhet të sigurojë bazat e monitorimit. Sipas klasave, mund të përdoren teknika të ndryshme observimi (vëzhgimi i zogjve, gracka për gjitarët e vegjël, karrem dhe kurthe fotografike për grabitqarët e mëdhenj).</p>	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
<p>Sondazhi bazë do të kërkojë afro dy vjet për t’u plotësuar.</p> <p>Monitorimi i zakonshëm mund të nisë dy vjet pas përfundimit të survejancës bazë</p>	<p>EEA ka specifikuar një rrjetë reference 10X10 km. Shqipëria është e ndarë në 345 ndarje të vogla.</p>
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
Indeksi i listës së kuqe për speciet evropiane (S)	
Autoriteti përgjegjës	AKM
Pasiguritë	

Emërtimi i indikatorit:	Zonat e (për)caktuara
Klasifikimi	Reagimi
Përkufizimi dhe Arsytimi	
Ky indikator ndryshimet me kalimin e kohës nga një formë mbrojtjeje që u jepet komponentëve të biodiversitetit. Indikatorit shpreh evolucionin e mbrojtjes së zonave natyrore në nivel vendi dhe progresin e politikave.	
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI
Metodologjia	
Indikatorit mat të gjithë sipërfaqen që është nën mbrojtje dhe ndryshimin relativ me kalimin e kohës. zonat përlogarit me km ² , por indikatorit mund të përfaqësohet edhe me % të të gjithë sipërfaqes së vendit. Kalimi i kufijve të zonave në një bazë të dhënash GIS mund të sjellë llogaritje automatike.	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Vjetore	Në mbarë vendin
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
Sitet e përcaktuara sipas Direktivave të BE-së për Habitatet dhe Zogjtë (R) mund gjithashtu të përdoren si indikator, duke qenë se direktivat inkorporojnë kuadrin kombëtar.	
Autoriteti përgjegjës	AKM
Pasiguritë	

Emertimi i indikatorit	Diversiteti i specieve
Klasifikimi	Statusi
Përkufizimi dhe Arsytimi	
<p>Objektivi i këtij indikator është të sigurojë indikatorë të përgjithshëm të nivelit të lartë që do të tregojnë statusin dhe tendencat e biodiversitetit. Përzgjedhja e specieve dhe grupeve të specieve bazohet kryesisht tek të dhënat e disponueshme dhe nevoja për të treguar tendencat e grupeve të ndryshme të specieve.</p>	
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI
Metodologjia	
<p>U bë një përzgjedhje e 24 specieve të zakonshme të zogjve karakteristike për një sërë habitatesh pyjore në Evropë. Zogjtë e përzgjedhur janë karakteristike për "tokat pyjore" ndonëse shumë prej tyre gjenden në habitate të tjera si: kopshte, shkurre etj. dhe përdorin edhe ato habitate.</p> <p>Këta zogj përdorin këto habitate specifike gjatë sezonit të tyre të mbarështimit dhe përfaqësojnë një gamë të gjerë në mbarë Evropën. Koordinatorët e monitorimit në rang kombëtar bëjnë vlerësimin e tyre – përqindjet e mbarështimit të popullatës kombëtare të specieve në një habitat të caktuar në këtë kategori (më pak se 25%, 25 deri 50%, 50 deri 75%, mbi 75%).</p>	
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Vjetore	Lloji i habitateve
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
Autoriteti përgjegjës	AKM
Pasiguritë	Ekzistenca e hartave të shpërndarjes/përhapjes së specieve për një periudhë afatgjatë është shumë e rëndësishme për garantimin e besueshmërisë së rezultateve. Kështu, indikatorët duhet të zbatohen për një kohë të gjatë në mënyrë që të sigurojnë rezultate më të mira.

Emërtimi i indikatorit:		Fragmentarizimi i zonave natyrore dhe gjysmë-natyrore (fragmentarizimi i terrenit, tokës dhe pyjeve)
Klasifikimi	Trysnia	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Ky indikator jep përqindjen dhe tendencat në zonat natyrore dhe gjysmë natyrore, mbi bazën e hartave të mbulesës së tokës. Indikatorit është shumë i rëndësishëm për aspektin e biodiversitetit, sepse tregon ndryshimet në shkallën e parcelave të zonave natyrore dhe gjysmë-natyrore për cilindo lloj ekosistemi në të gjithë Evropën.</p> <p>Indikatorit lidhet gjithashtu me mbrojtjen e Panoramës dhe Menaxhimin e zonave bregdetare, sipas përkufizimit në Protokollin për Menaxhimin e zonës bregdetare mesdhetare</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI	
Metodologjia		
Sigurohet nga përlogaritjet matematikore dhe analiza GIS për të dhënat për mbulesën e tokës CORINE (CLC)		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Çdo 6 vjet (përditësimi i CORINE)	Në mbarë vendin	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	AKM	
Pasiguritë	Në shumë raste të dhënat CORINE kanë nevojë të verifikohen me kampionet <i>in situ</i> për të vlerësuar saktësinë e tyre.	

Emërtimi i indikatorit:		Bujqësia: zona sipas praktikave të menaxhimit që mbështesin në potencë biodiversitetin
Klasifikimi		Trysnia
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Ky indikator bazohet mbi dy nënindikatorë dhe tregon tendencat në hapësirë (si përqindje e hapësirës totale në përdorim) të dy kategorive të tokës bujqësore të cilat nuk përjashtojnë njëra-tjetrën:</p> <p>a. zona fermere me vlera të mëdha natyrore.</p> <p>b. zona të fermave organike.</p> <p>a. zonat fermere me vlera të mëdha natyrore (ha) u referohen zonave ku sisteme fermere nxisin një nivel të lartë biodiversiteti. Shpesh ato karakterizohen nga praktika ekstensive fermere, që lidhen me specie e larta dhe diversitetin e habitateve apo praninë e specieve që përbëjnë shqetësim për sa i takon konservimit në rang evropian.</p> <p>b. zona të fermave organike (ha) tregojnë tendencat në zonat e fermave organike dhe pjesën që zënë hapësirat e fermave organike si totali i sipërfaqes bujqësore të përdorur. Fermat konsiderohen organike në nivelin e Bashkimit Evropian (BE) vetëm kur janë në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007, që garanton një kuadër gjithëpërfshirës për prodhimin e të lashtave dhe blegtorinë; etiketimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve organike; dhe importin e produkteve organike në BE.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet		BIODIVERSITETI
Metodologjia		
<p>a. zonë fermere me vlerë të lartë natyrore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) përzgjedhja e klasave të mbulesave të tokës që përbëhen kryesisht nga toka me vlera të larta natyrore në zonat e ndryshme mjedisore të Evropës; 2) përmirësimi i hartës të marrë në pikën 1) bazuar mbi rregulla shtesë të ekspertëve dhe informacionin specifik sipas vendit; 3) nivelet e të dhënave të biodiversitetit (NATURA 2000, IBA – mbi bazën e specieve indikatore dhe vetëm për habitatet e përzgjedhura); 4) testimi/shtimi i grupeve të të dhënave kombëtare për biodiversitetin. <p>b. Zona të fermave organike</p> <p>Përlllogaritja e indikatorit sipas vendit/rajonit: Ministria e Bujqësisë mban të dhënat statistikore të pyetësorit për fermat organike.</p>		
Frekuenca e matjeve		Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Çdo 6 vjet (azhurnim i CORINE) për zonat me vlera të larta natyrore, çdo vit, për fermat organike		Në mbarë vendin
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		

Autoriteti përgjegjës	Ministria e Bujqësisë	
Pasiguritë		

Pyjet

Emërtimi i indikatorit:		(C1). Mirëmbajtja, përmirësimi dhe rritja e burimeve pyjore; kontributi i tyre në ciklin global të karbonit. b) zonat pyjore sipas klasave të moshës, tipologjisë dhe volveve; g) sasia e biomasës në pyje; h) Biomasa që largohet çdo vit nga pyjet;
Klasifikimi	Statusi	
Përkufizimi dhe Arsyeja		
<p>Kriteri është përqendrimi te kontributi i pyjeve në ciklin global të karbonit që mund të përcaktohet përmes hapësirës, volumit dhe strukturës së pyjeve. Stoku në rritje është një nga statistikat bazë të çdo inventari pyjor dhe i dobishëm për qëllime të ndryshme. Volumi aktual i stokut në rritje duke aplikuar faktorët e zgjerimit të biomasës mund të konvertohet në vlerësime të biomasës drusore mbi dhe nën tokë. Të dhënat në lidhje me stokun në rritje, rritjet dhe rëniet (prerjet) janë të rëndësishme për përlogaritjen e buxheteve të karbonit në sektorin pyjor.</p> <p>Në fillim kriteret përmbanin këta indikatorë:</p> <p>Indikator 1.1 zona pyjore: Hapësira pyjore dhe toka të tjera pyjore, klasifikuar me pyje gjethegjera dhe konifere dhe nga disponueshmëria për furnizimin me dru dhe pjesës së tokës pyjore dhe toka të tjera pyjore si total i hapësirës tokësore.</p> <p>Indikator 1.2 Stoku në rritje: Stoku në rritje dhe tokat e tjera pyjore, i klasifikuar sipas pyjeve gjethegjera dhe konifere dhe sipas disponibilitetit për furnizimin me dru.</p> <p>Indikator 1.3 Struktura e moshës dhe/ose shpërndarja diametrike e pyllit: Struktura e moshës dhe/ose shpërndarja diametrike e pyjeve dhe tokave të tjera pyjore, klasifikuar sipas llojit të pyllit dhe sipas disponibilitetit për furnizim me dru.</p> <p>Indikator 1.4 Stoku i karbonit: stoku i karbonit të biomasës drusore dhe dherave në pyje dhe të tjera hapësira pyjore.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI/ndryshimet klimatike	
Metodologjia		
<p>Përlogaritja e hapësirës/zonës dhe klasifikimi i pyjeve sipas llojeve që mund të vlerësohen përmes përdorimit të imazheve satelitore (<i>Remote Sensing</i>). CORINE aktualisht siguron një klasifikim të përgjithshëm. Përlogaritjet e volumit kërkojnë procedurë kampionimi dhe përpilimin e inventarëve me qëllim azhurnimin e të dhënave të mëparshme.</p> <p>Përlogaritjet e stokut të përgjithshëm (m³) dhe vëllimit të stokut (m³/ha pyll) sipas llojit të pyjeve dhe sipas disponibilitetit për furnizim me dru sigurojnë informacion bazë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së menaxhimit të pyjeve dhe mund të përcaktohen përmes kampionimit.</p> <p>Të dhënat mblidhen sipas grupit të kriterëve dhe indikatorëve pan-evropiane për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve të miratuar nga Konferenca e 4-t Ministrore (Forest Europe, që më parë njihet si Konferenca Ministrore për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë) e mbajtur në Vjenë në vitin 2003.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
5-20 vjet	Zonat pyjore	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
pyjet: Stoku në rritje, rritja, rëniet dhe drutë e vdekur		
Autoriteti përgjegjës	AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale	
Pasiguritë		

Emërtimi i indikatorit:	(C2). Ruajtja e ekosistemeve pyjore, shumëllojshmëri e pyjeve f) sasi të vjetore të mbledhura, të përdorura, të ndara sipas përpunimit të drurit dhe dru zjarri k) zonat e dëmtuara nga faktorë të tjerë atmosferikë, si p.sh.: stuhi, reshje dëbore etj.; j) zona të djegura nga zjarret; l) llojet e pemëve të rrezikuara; m) pika problematike pyjore;
Klasifikimi	Trysnia
Përkufizimi dhe Arsyetimi	Ekosistemet pyjore janë vulnerabël ndaj ndotjes (uji dhe ajrit), fenomeneve të ndryshimeve klimatike, (zjarre, përmblytje, shkretëtirëzim), sëmundjeve, kullotave, pushtimi i specieve të huaja dhe veprimtarive njerëzore. Monitorimi i këtyre parametrave është shumë i rëndësishëm për të garantuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve pyjore.
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI
Metodologjia	Inventari i dëmit që u shkaktohet pyjeve mund të bëhet përmes përqendrimit të raporteve dhe raporteve të incidenteve nga shërbimet përkatëse pyjore. Pyjet dhe hapësirat e tjera me pyje të dëmtuara duhet të klasifikohen sipas agjentit primar që ka shkaktuar dëmin (abiotik, biotik dhe i shkaktuar nga veprimtaritë njerëzore) si edhe sipas llojit të pyllit. Matja bëhet kryesisht me njësi toke (Ha). Observimet për evidentimin dhe matjen e nivelit të infektimit në pyje të shkaktuara nga sëmundjet dhe insektet e dëmshme do të kryhen për këto lloje pemësh: pisha e zezë, pisha mesdhetare, fieri i bardhë. Depozitimi i substancave kimike (squfur, azot) do të matet me anë të kampioneve të marra nën tendën pyjore të parcelave të monitorimit intensiv (kg/ha). Përbërja kimike e dheut (pH, kapaciteti i shkëmbimit të kationit, raporti C/N, C organike) të pyjeve dhe në dhera të tjera për sa i takon aciditetit dhe eutrofizimit të dheut klasifikohet sipas llojeve kryesore të dheut. Të dhënat mblidhen sipas grupit të kriterëve dhe indikatorëve pan-evropiane për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve të miratuar nga Konferenca e 4-t Ministrore (Forest Europe, që më parë njihet si Konferenca Ministrore për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë) e mbajtur në Vjenë në vitin 2003.
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet
5-10 vjet	Zonat/fushat e kampionimit
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:	
Autoriteti përgjegjës	AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale
Pasiguritë	

Emërtimi i indikatorit:	(C3). Mirembajtja dhe inkurajimi i funksioneve të prodhimit në pyje i) kapaciteti vjetor i shfrytëzimit; e) rritja vjetore e pyjeve bazuar mbi formën e qeverisjes dhe tipologjinë;	
Klasifikimi	Reagimi	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Lënda drusore dhe produktet e tjera pyjore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për komunitetet lokale. Përmes aktiviteteve pyjore, njeriu luan një rol rregullator në pyje i cili në rastin e menaxhimit të qëndrueshëm ka rezultate fitimprurëse. Në të kundërt, mbishfrytëzimi i lëndës drusore, fragmentarizimi dhe keqmenaxhimi mund të çojë në kolaps të ekosistemeve.</p> <p>Balanca midis rritjeve dhe rënieve nxjerr në pah qëndrueshmërinë e prodhimit të lëndës drusore me kalimin e kohës, si edhe disponueshmërinë reale dhe potencialin për disponueshmëri në të ardhmen të lëndës drusore. Për të garantuar qëndrueshmërinë vjetore afatgjatë, rëniet nuk duhet ta kalojnë rritjen vjetore neto.</p> <p>Rritja e stokut, përkundërt hapësirës pyjore është tregues i maturimit të pyjeve. Balanca midis rritjes dhe prerjeve në prodhimin e pyjeve është treguesi më i mirë për të kuptuar si potencialin e mundësive për prodhim të lëndës drusore, ashtu edhe kushtet e biodiversitetit, shëndetit, argëtimit dhe funksione të tjera që kanë pyjet. Cilësia e këtij indikator për sa i takon biodiversitetit do të përmirësohet ndjeshëm, në rast se do të zbatoheshin sugjerimet e mëposhtme për përmirësime.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	PYJET	
Metodologjia		
<p>Rënia e drurëve nënkupton volumin mesatar vjetor të volumit që mbetet (mbi lëvoren) të të gjitha pemëve, të gjalla apo të kalbura, mbi 0 cm diametër në lartësi të gjoksit që priten çdo vit. Rritja vjetore neto përfaqëson volumin mesatar vjetor të rritjes bruto duke zbritur këtu humbjet natyrore të të gjitha pemëve me një diametër minimal 0 cm (d.b.h.). Të dhënat mblidhen sipas grupit të kriterëve dhe indikatorëve pan-evropiane për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve të miratuar nga Konferenca e 4-t Ministrove (Forest Europe, që më parë njihet si Konferenca Ministrove për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë) e mbajtur në Vjenë në vitin 2003.</p> <p>Druri për mobilie (me trung të rrumbullakët) përfshin drurin që përftohet nga largimi, duke përfshirë drurin e rikuperuar nga humbjet natyrore, prerjet. Trungjet e rrumbullakët mund të ndahet më tej në dru industrial (druri në dorë të parë), që përdoret kryesisht për ndërtim dhe produkte të drurit të përpunuar, dhe dru për lëndë djegëse, që vjen e bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm si burim i energjisë së rinovueshme. Prodhimi i drurëve të rrumbullakët shërben si ndërfaqe midis pyjeve dhe sektorit të lëndës drusore: ai garanton të ardhura për pronarët e pyjeve, shërben si burim për sektorin e lëndës drusore dhe është një vlerë e shtuar për ekonominë e vendit, në veçanti në zonat rurale.</p>		
	Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet

Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:

Pyjet: stoku në rritje, rritjet dhe rëniet, drurët e vdekur

Autoriteti përgjegjës

AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale

Pasiguritë

Emërtimi i indikatorit:		(C4). Mirëmbajtja , Konservimi dhe Përmirësimi i diversitetit biologjik në pyje. o) diversiteti i ekosistemeve dhe i habitateve pyjore;
Klasifikimi	Statusi	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>Kriteri 4 përqendrohet te përbërja e habitateve dhe specieve pyjore. Identifikimi i diversitetit të specieve dhe fokusi te specie me interes dhe biota e tyre është objektivi kryesor për indikatorin. Biodiversiteti pyjor është një term i gjerë i cili i referohet të gjitha formave të jetës brenda zonave të pyllëzuara dhe roleve të tyre ekologjike. Si i tillë biodiversiteti pyjor përfshin jo vetëm pemët, por dhe një sërë bimësh, kafshësh dhe mikroorganizmash që popullojnë zonat pyjore dhe diversitetet përkatëse gjenetike. Ai mund të konsiderohet në nivele të ndryshme, duke përfshirë ekosistemin, panoramën, speciet, popullatat dhe gjenetikën. Ndërveprime komplekse mund të ndodhin brenda për brenda dhe midis këtyre niveleve. Në pyje të ndryshme biologjike, ky kompleksitet u bën të mundur organizmave të përshtaten në kushte të një mjedisi vazhdimisht në ndryshim dhe të ruajnë funksionet e ekosistemit. Parametra të tjerë cilësore që duhet të vlerësohen janë: shkalla e materialit fizik të pyjeve dhe futja e specieve të huaja.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	PYJET/BIODIVERSITETI	
Metodologjia		
<p>Matja e këtij indikator mund të kombinohet me punë në terren duke iu referuar "Specieve/Habitateve me interes evropian". Sipas programimit aktual ka një projekt në vazhde për "Monitorimin e burimeve gjenetike pyjore dhe biodiversitetit në popullatat e fierit dhe pishës së zezë". Matjet dhe observimet e këtij projekti do të bëhen çdo pesë vjet në rrjetin SP në 36 lokacione; rezultati do të jetë vjetor dhe i krahasueshëm me pesë vitet e mëparshme në të njëjtat stacione.</p> <p>Gjithashtu pritet të nisë një projekt për rigjenerimin e pyjeve dhe të mbështesë kriterin C4. Observimet dhe matjet do të bëhen çdo pesë vjet në zona të shfrytëzuara, të riprera dhe të pyllëzuara në 61 lokacione (bashki), dhe rezultatet do të jenë vjetore dhe të krahasueshme me periudhën e mëparshme pesëvjeçare.</p> <p>Pyjet e përhershme dhe parcelat pyjore të ndara nga toka jopyjore mund të maten me sisteme imazhesh satelitore (<i>remote sensing</i>) dhe GIS duke përcaktuar kriteret hapësinore.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
5-10 vjet	Zonat e kampioneve	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale	
Pasiguritë		

Emërtimi i indikatorit:			(C5). Mirëmbajtja , përmirësimi dhe stimulimi i funksioneve mbrojtëse në pyje.
Klasifikimi	Reagimi		
Përkufizimi dhe Arsyetimi			
Shërbimet e ekosistemit për pyjet dhe drurët e tjerë sigurojnë parandalimin e erozionit dhe përmbytjet, mbrojtjen e burimeve ujore, rregullojnë klimën (sidomos në pyjet peri-urbane) dhe funksione të tjera të vlefshme mbrojtëse. Kriteri- indikatori ka për qëllim të sigurojë informacion në lidhje me ato shërbime dhe me diferencimin e tyre me kalimin e kohës. Pyjet mbrojtëse – toka, uji dhe funksionet e tjera të ekosistemit - infrastrukturë dhe burime natyrore të menaxhuara			
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI		
Metodologjia			
Zonat pyjore dhe sipërfaqe të tjera pyjore që janë përcaktuar për parandalimin e erozionit të dherave, për ruajtjen e burimeve ujore, ruajtjen e funksioneve të tjera mbrojtëse, mbrojtjen e infrastrukturës dhe burimeve të menaxhuara natyrore kundër rreziqeve natyrore janë baras me të gjithë sipërfaqen e pyllëzuar të vendit.			
Frekuenca e matjeve		Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
5-10 vjet			
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:			
Autoriteti përgjegjës	AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale		
Pasiguritë			

Emërtimi i indikatorit:			(C6). Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve të tjera social - ekonomike a) Fondi pyjor (bazuar mbi pronësinë, format e qeverisjes, tipologjinë dhe volumet); n) sitet me rëndësi të posaçme për biodiversitetin, turizmin etj.;
Klasifikimi	P		
Përkufizimi dhe Arsyetimi			
<p>Pyjet janë shumë të rëndësishme për zhvillimin lokal të komuniteteve malore dhe atyre gjysmë-malore në shumë aspekte. Pyjet sigurojnë të ardhura dhe punë për ato zona. Përveç pyjeve dhe pemëve frutore, shërbimet e ekosistemeve janë një aset për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, që çon në diferencimin (e dëshirueshëm) të sistemeve prodhuese rurale. Te kriteret përfshihen parametra të tillë si:</p> <p>Politikat, institucionet dhe instrumentet për ruajtjen e kushteve dhe funksioneve të tjera ekonomiko-shoqërore</p> <p>Pronat pyjore: Kontributi i sektorit pyjor në GDP</p> <p>Të ardhurat neto</p> <p>Investimet në pyje dhe sektorin e pyjeve</p> <p>Fuqia punëtore e sektorit pyjor</p> <p>Siguria dhe shëndeti në punë</p>			
Kuadri i politikave dhe synimet	BIODIVERSITETI		
Metodologjia	Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Indikatori bazohet kryesisht mbi interpretimin e të dhënave statistikore të aktiviteteve përkatëse ekonomike	çdo vit	Në mbarë vendin	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:			
Autoriteti përgjegjës	AKM në bashkëpunim me agjencitë rajonale dhe lokale		
Pasiguritë			

Emërtimi i indikatorit:		Çlirimi i ndotësve nga impiantet industriale
Klasifikimi		Trysnia/Impakti
Përkufizimi dhe Arsytimi		
<p>Industritë e prodhimit përgjigjen për shkarkimet e mëdha në ajër, ujë dhe për mbetjet. Prodhimi i produkteve sjell për pasojë një sërë shkarkimesh të ndryshme, në varësi të produkteve që prodhohen dhe nga proceset dhe kimikatet që përdoren. Shkarkimet në ujë përfshijnë metalet e rënda (si p.sh. kadmium, merkur), mikro ndotës organikë, trupa të ngurtë pluskues dhe lëndë organike që ndikojnë në statusin kimik të trupave ujqorë. Mund të ketë edhe shkarkime në ajër, përveç gazit GES dhe ndotësve fotokimikë, komponimet toksike si dioksina PAH, furanet (hidrokarbure të klorinuara). Për sa u takon mbetjeve, qoftë volume të mëdha të mbetjeve organike apo produktet me nivel të lartë toksik që mund t'u shkaktojnë dëme serioze ujërave dhe ekosistemeve.</p> <p>Direktiva për Parandalimin e Integruar të Kontrollit të Ndotjeve (IPPC) përcakton kuadrin e monitorimit në nivel individual.</p> <p>Direktiva Kuadër e Ujit (WFD) parashtron strategjinë kundra ndotjes së ujit dhe kërkon masa të mëtejshme specifike për kontrollin e ndotjes dhe standardet e cilësisë së mjedisit (EQS). Në përputhje me nenin 4 të WFD, shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme me qëllim uljen progresive të ndotjes nga substancat prioritare dhe pushimin apo ndalimin e shkarkimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të substancave prioritare të rrezikshme.</p> <p>Pasojat e aktiviteteve ekonomike për sa i takon cilësisë dhe sasisë së ujit janë analizuar në kuadrin e WFD përmes planeve të menaxhimit të baseneve lumore të vendeve anëtare. Studimi i lidhjes midis statusit të ujit (cilësisë dhe sasisë), presioneve përkatëse dhe forcave shtytëse ekonomike siguron një bazë të rëndësishme për prioritizimin e masave në lidhje me realizimin e objektivave të WFD. Për më tepër, mund të ndihmojë për të kuptuar nëse ka pasur dyfishim të rritjes ekonomike në një industri/sector të caktuar, nga impakti i vet mjedisor dhe rrjedhimisht nëse sektori po ecën përpara drejt efikasitetit më të lartë të burimeve. Do të nevojiten tregues që kuptohen me lehtësi, si sinjale dhe mënyra për të matur progresin në lidhje me përmirësimin e efikasitetit të burimeve.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet		Të tjera
Metodologjia		
<p>Për ndotjen e ajrit dhe prodhimit e mbetjeve toksike, inventarët bazohen mbi detyrimet e monitorimeve individuale brenda termave të lejes mjedisore. Të dhënat duhet të mbështeten nga zyrat rajonale.</p> <p>Metodologjia EEA në lidhje me dyfishimin e ndotjes industriale përdor një formulë që kombinon gjetjet nga sistemi i monitorimit të ujit dhe ato të degës ekonomike (Branch Economic Accounts) (statistikave kombëtare). Formula e përdorur për llogaritjen e vlerave të indikatorit, sipas metodologjisë EEA është:</p> $X = E/Y$ <p>ku E është shkarkimi i agregateve të metaleve/nutrientëve në ujë dhe Y është vlera bruto që i shtohet çmimeve bazë.</p> <p>Agregimi i nutrientëve bazohet mbi metodologjinë LCA, ku është përdorur ekuacioni i mëposhtëm për konvertimin e Ntot në ekuivalentin e Ptot, Ekuivalenti i nutrientit</p> $(P) = -L_N^*/7,23 + L_P (P)$ <p>Ku $L_N = N_{tot}$ ngarkesa e shkarkimit dhe $L_P = P_{tot}$ ngarkesa e shkarkimit</p> <p>Agregimi i metaleve të rënda bazohet mbi shuma absolute të kg të ndotësve që çlirohen, ponderuar me faktorë që u korrespondojnë vlerave reciproke. Përqendrimet që parashikohen të mos kenë efekt (<i>Predicted No Effect Concentrations</i>) (PNEC) (1/PNEC) për çdo ndotës dhe që ekuivalentohen me një nga metalet – në këtë rast është përzgjedhur merkuri (Hg). Në rast se ekuivalentohet me një metal tjetër, diagrama do të ketë të njëjtën pamje, por një shkallëzim tjetër në aksin e koordinatave. Kjo është bërë për të reflektuar diferencat në impaktin mjedisor të katër metaleve të rënda mbi Listën e Substancave Prioritare në fushën e politikave të ujit.</p>		
Frekuenca e matjeve		Mbulimi gjeografik – zhvillimet
Çdo 5 vjet		Në mbarë vendin
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës		AKM në bashkëpunim me 12 Agjencitë Rajonale të Mjedisit
Pasiguritë		

Emërtimi i indikatorit:		Mbetjet e ngurta: Prodhimi i mbetjeve, riciklimi i mbetjeve, Devijimi i mbetjeve nga landfilli
Klasifikimi	Trysnia	
Përkufizimi dhe Arsyeimi		
<p>Indikatorët e propozuar kryesorë të EEA-së (WST 004 prodhimi i mbetjeve, WST 005 riciklimi i mbetjeve dhe WST 006 largimi i mbetjeve nga landfilli) mbi mbetjet trajtojnë aspekte përkatëse të politikave, që u referohen objektivave dhe synimeve të Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet (viti 2008) (2008/98/KE) dhe direktivave të tjera përkatëse, Hartës udhëzuese të vitit 2011 për një "Evropë që i përdor burimet me efikasitet" (<i>Resource Efficient Europe</i>) (COM(2011)571) dhe Programin e 7-të për Veprimet për Mjedisin (EAP). Këto aspekte të politikave duhet të lidhen me programin e infrastrukturës për Menaxhimin e Mbetjeve që tashmë ka nisur nga puna.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	Mbetjet	
Metodologjia		
<p>Inventarët për regjistrimin e sasisë së mbetjeve përmes praktikave të hedhjes/menaxhimit duhet të mbahen nga autoritetet vendore/menaxherët e infrastrukturave. Të dhënat përmbledhen sipas praktikës apo sipas periudhës së evidencave të vlerësimit që duhet të ketë çdo sistem menaxhimi.</p>		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Vjetore	Në mbarë vendin	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	Ministria e Brendshme në bashkëpunim me konvergjenat lokale.	
Pasiguritë	Në shumë raste duhet të bëhen korrigjime për të përlllogaritur sasi të që menaxhohen jashtë të ashtu-quajturit "sistem zyrtar". Këtu përfshihen si "praktikat e këqija" (p.sh. largimi i paligjshëm i mbetjeve), ashtu edhe "praktikat e mira" (si p.sh. ri-përdorimi i menjëhershëm).	

Emërtimi i indikatorit:		Dheu: Zonat e kontaminuara
Klasifikimi	Trysnia	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
<p>është një indikator përshkrues që ka për qëllim paraqitjen e evolucionit të situatës aktuale dhe praktikave të menaxhimit për dekontaminimin e zonave të cilat historikisht kanë qenë të kontaminuara kryesisht nga substanca të rrezikshme apo toksike.</p> <p>Ato janë 14 pika problematike prioritare të njohura nga një projekt i PNUD-it "Mbi identifikimin e zonave prioritare të ndotura në Shqipëri" ku është përcaktuar nevoja për ndërhyrje emergjente, me qëllim minimizimin e riskut në mjedis dhe shëndetin e njeriut.</p>		
Kuadri i politikave dhe synimet	MBETJET	
Metodologjia		
Raporte progresi		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Vjetore	14 pika problematike	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	AKM	
Pasiguritë		

Emërtimi i indikatorit:		GDP, popullata në total
Klasifikimi	Forcat shtytëse	
Përkufizimi dhe Arsyetimi		
Indikatorët që shprehin kushtet e përgjithshme ekonomiko-shoqërore		
Kuadri i politikave dhe synimet	Skenarët mjedisorë	
Metodologjia		
Matje statistikore		
Frekuenca e matjeve	Mbulimi gjeografik – zhvillimet	
Vjetore	Në mbarë vendin	
Indikatorë shtesë që mund të sigurohen nga grupi i të dhënave primare:		
Autoriteti përgjegjës	INSTAT	
Pasiguritë		

*Burimi: Botim i GEF, Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP: Vlerësimi i kapaciteteve kombëtare për monitorimin e indikatorëve mjedisor.

2. Mekanizmi i Koordinimit dhe Procedurat e Zbatimit

Sipas VKM-së të vitit 2009 për monitorimin, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave është caktuar si autoriteti përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vend, dhe me mbështetjen e EFA (tashmë AKM), mbikëqyr aktivitetet e monitorimit që zbatohen nga institutet përkatëse. Njëkohësisht ajo është përfituesja kryesore dhe dikasteri që mban monitorimin e të dhënave të mbledhura.

Sipas dispozitave të ligjit të vitit 2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", AKM do të jetë autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit ku përfshihen të gjitha institucionet që kanë detyra që në një mënyrë apo në një tjetër lidhen me mjedisin.

Ministri të tjera të përfshira në VKM për monitorimin janë:

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
- Ministria e Mbrojtjes (Shërbimi Meteorologjik)
- Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (survejanca gjeologjike)
- Ministria e Shëndetësisë (Instituti i Shëndetit Publik)
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Ministria e Mjedisit (AKM)
- Ministria e Brendshme (pushteti vendor – që përgjigjet për menaxhimin e mbetjeve)

1.1.2 Kostimi dhe buxheti

Në bashkëpunim me UNDP-në, AKM-ja (duke pasur parasysh nevojën për kosto fikse (pajisje) dhe nevojën për punën mbështetëse shkencore për të dokumentuar vlerat bazë për monitorimin), ka analizuar kostimin dhe buxhetimin e sistemit të informacionit të monitorimit për një periudhë 5 vjeçare.

Buxheti përbëhet nga "moduli" që u referohen proceseve të veçanta (indikatorëve apo grupeve të indikatorëve) me qëllim që të kemi një zbatim në letër (*a la carte implementation*), sipas mundësive financiare. Kjo do të mbështesë një strategji investimesh afatmesme fleksibël dhe do të sigurojë shfrytëzimin e të gjitha burimeve të mundshme financiare (që shumicën e rasteve nuk janë të sinkronizuara). Do të llogariten dy skenar’:

- I pari do të ketë të gjitha kostot e nevojshme për zbatimin e plotë të programit të propozuar;
- I dyti do të jetë i kufizuar te buxheti më i mundshëm për t’u përballuar, duke marrë në konsideratë: i) mekanizmin ekzistues, ii) përpilimin e politikës kombëtare (dhe zbatimin e planeve përkatëse/infrastrukturës), përpjekjet financiare për ta mbajtur secilin prej indikatorëve.

Midis këtyre dy skenarëve, të gjithë skenarët e ndërmjetëm mund të zbatohen në varësi të burimeve të disponueshme dhe nevojave intensive.

Rrjedhimisht, disponueshmëria e burimeve financiare do të paraqitet për çdo modul. Vlerësimi i disponueshmërisë do të përcaktohet për sa i takon "së drejtës për të përfituar" (*eligibility*), por edhe për sa i takon "qëndrueshmërisë". Kjo e fundit është esenciale sepse është konstatuar se në shumë raste financimi i këtyre veprimeve përmes programeve ndërkombëtare nuk garanton vijueshmërinë e monitorimit apo veprimet e menaxhimit pas përfundimit të mbështetjes financiare.

Kostimi i veprimeve dhe modulet

Veprimi I: Ngritja e një sistemi informacioni gjeohapësinor për monitorimin mjedisor.

Prokurimi, instalimi, zhvillimi dhe nevojat e trajnimit me qëllim ngritjen e një sistemi informacioni gjeohapësinor për monitorimin mjedisor dhe menaxhimin jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Kostimi i sistemit të informacionit

Sistemi i monitorimit GIS	Kosto për njësi	Sasia	Totali
I. Blerja dhe instalimi i harduerëve dhe softuerëve			
Serverët (aplikacioni dhe sistemi operativ i databazës)	2600 €	1	2600 €
Kompjuterë (duke përfshirë OS)	1100 €	14	15 400 €
Softuerë për databazën	15 000 €	3	45 000 €
Licenca e serverit GIS	20 000 €	2	40 000 €
Licencat GIS për Desktop	2500 €	12	30 000 €
Softuerë për Remote sensing	3500 €	2	7000 €
Firewalls dhe mbrojtje nga viruset kompjuterike		-	6000 €
Rrjeti			1500 €
Tabelat për të dhënat in situ (softuerë)	600 €	6	3600 €
Mjete konsumi (në vit)	2000 €	5	2000 €
Të tjera (skanera, plotera, hard disqe të jashtme etj.)			10 000 €
II. Zhvillimi i softuerëve			
Moduli për analizën hapësinore	1000 €	12	12 000 €
Softuerë për publikimet në ueb	2500 €	2	5000 €
III. Shërbimet (muaj pune)			
Vlerësim i zbatimit	2200 €	6	13 200 €
Dixhitalizimi dhe importimi i të dhënave ekzistuese	1300 €	60	78 000 €
QA/QS dhe protokollet për hedhjen e të dhënave (përfshirë edhe certifikimin)	3500 €	24	84 000 €
Krijimi i platformës GIS	2000 €	30	60 000 €
Trajnimi (orë pune)	8 €	1200	9600 €
Shpërndarja dhe Publiciteti			15 000 €
TOTAL			439 900 €

Veprimi II: përpilimi i të dhënave

Moduli a - Ndryshimet klimatike:

Matja e temperaturës mesatare dhe sasisë së reshjeve atmosferike nuk kërkon kosto shtesë. Instalimi i stacioneve automatike meteorologjike që do të sigurojnë të dhëna të vazhdueshme *online* është i dëshirueshëm, por jo i nevojshëm. Çmimi mesatar për një stacion të tillë (bashkë me regjistrin e të dhënave dhe modem GPRS) përllogaritet te 3000 euro për stacion.

Niveli i ujërave nëntokësore matet me gausmetër kontakti (portativ ose fiks). Autoriteti përgjegjës (Shërbimi Gjeologjik) ka pajisjet e duhura.

Matja e nivelit të detit bëhet nga EEA për të gjitha detet e kontinentit evropian.

Inventarët e GES sipas legjislacionit të BE-së dhe traktatet ndërkombëtare (IPCC) do të mbulojnë nevojat për përllogaritjen e indikatorëve dhe shkarkimeve të gazeve me efekt serrë. Siç është theksuar tashmë, llogaritjet bazohen mbi algoritme që përcaktojnë të dhëna statistikore dhe hapësinore në lidhje me tregun e energjisë, modelet e lëvizshmërisë, prodhimin e mallrave (primare dhe industriale), përdorimin e tokës, karakteristikat cilësore dhe sasiore të pyjeve dhe prodhimi i ndotjes nga kompanitë e mëdha industriale. Përllogaritje të tilla kërkojnë përkushtimin e stafit me kualifikime të larta shkencore dhe sugjerohet të sigurohen nga jashtë nga një institucion i përshtatshëm me qëllim që të mos mbingarkohen funksionet e AKM-së (që do të mbajë përgjegjësinë e vlefshmërisë të rezultateve). Kostimi i kësaj detyre llogaritet në dy pjesë, si vijon:

- Inventari i gazit me efekt serrë dhe raportimi mbi zbatimin e ligjit evropian dhe konventave ndërkombëtare mbi pesë fushat kryesore të aktivitetit njerëzor (energja, procesi industrial, tretësit, bujqësia dhe mbetjet).
- Inventari i gazit me efekt serrë dhe raportimi mbi zbatimin e ligjit evropian dhe konventave ndërkombëtare mbi përdorimin e tokës, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe pyjeve.

Duhet theksuar se kostot e mëposhtme mbulojnë të gjitha detyrimet kombëtare në lidhje me zbatimin e KKKBNK-së dhe jo vetëm monitorimin mjedisor.

Tabela 3. Kostimi për monitorimin e zbutjes së ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike	Ditë pune	Kosto për njësi	Totali
i. Pajisjet			

Regjistruarit e të dhënave dhe modemet për të dhëna të vazhdueshme meteorologjike	3000	10	30 000 €
ii. Inventarët e gazit me efekt serrë (cikël katër vjeçar monitorimi)			
Pjesa 1: Inventarët për 5 sektorë bazë			(200 000 €)
Mbledhja e të dhënave dhe inputet nga autoritetet lokale dhe qendrore	150	450	67 500 €
Tabelat CRF që përmbajnë llogaritjet për shkarkimet dhe informacionin përkatës, sipas neneve 7.1 dhe 7.2 të Rregullores 525/2013	250	280	70 000 €
Raportim mbi hartimin e strategjive për uljen e shkarkimeve (neni 4)	300	50	15 000 €
Raportim mbi zbatimin e masave që lidhen me nenet 12 dhe 13 të rregullores 525/2013	300	40	12 000 €
Raporti i inventarit kombëtar të GES	300	120	36 000 €
Pjesa 2: Inventari LULUCF			(95 000 €)
Mbledhja e të dhënave nga agjencitë qendrore dhe lokale pyjore	150	180	27 000 €
Inventari i shkarkimeve dhe absorbimit në përputhje me aneksin I të vendimit 529/2013/BE që nënkuptojnë kategoritë e pyllëzimit, shpyllëzimit, menaxhimit pyjor, menaxhimit të tokës bujqësore, menaxhimit të tokës për kullotje	250	200	50 000 €
Llogari vjetore për shkarkimet dhe largimet	300	60	18 000 €
Totali			- €
Procedurat QA/QS	250	60	5000 €
Përfundimi i Komunikimit Kombëtar	300	80	24 000 €
Modelimi i indikatorit të grupit të shkarkimeve nga sektori i transportit	300	25	7500 €
Totali			342 000 €

Përqindja e **energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë** duhet të bëhet e disponueshme përmes autoriteteve rregullatore të energjisë. Indikatori i **efiçencës së energjisë**

do të llogaritet në raportin vjetor të zbatimit të planit kombëtar të veprimit (siç përcaktohet në EED 2012/27/BE dhe kur të miratohet).

Monitorimi i Erozionit të dherave dhe erozionit bregdetar bëhet sipas modeleve që përdorin të dhëna të lira (imazhe LANDSAT, CORINE BD, bazën e evropiane të të dhënave gjeografike për dheun (European Soil Geographical Database) etj.) Kostoja e prodhimit do të vlerësohet nga numri i ditëve të punës që duhen për:

- Të mbledhur, importuar dhe përpunuar të dhënat,
- Të ngritur dhe kalibruar modelet,
- dhe prodhuar raportin.

Totali i numrit të ditëve të punës për një cikël 6 vjeçar monitorimi parashikohet të 700 dhe kostoja totale të 180 000 €.

Moduli b – Ndotja e ajrit

Skenari bazë supozon që monitorimi i ndotjes së ajrit bazohet mbi pajisjet ekzistuese. Në këtë rast, kostot u referohen dy kategorive bazë: a) ruajtjes së kostove për pajisjen ekzistuese, b) kostove për kampionet dhe analizat kimike. Skenari i zbatimit të plotë supozon instalimin e 8 stacioneve automatike shtesë që do të mbulojnë edhe 3 pika të tjera në Tiranë (5 në total), një stacion shtesë në Durrës dhe në Vlorë dhe qendrat e tjera urbane me popullatë mbi 50 000 banorë.

Tabela 4 : Kostimi i modulit për monitorimin e ajrit

Monitorimi i ajrit	Në përgjithësi			Buxheti	
	Kosto për njësi	Sasia	total	Sasia	Total
I. kostoja e pajisjeve dhe e mirëmbajtjes					
a. stacionet automatike					
Azhurnimi i stacioneve automatike (pajisjet, modem, regjistri i të dhënave)	18 500,00 €	8	148 000,00 €		- €
Mirëmbajtje vjetore	4500,00 €	15	67 500,00 €	7	31 500 €
Kosto për materiale konsumi dhe kosto funksionale (duke përfshirë energjinë elektrike)	5000,00 €	15	75 000,00 €	7	35 000 €
Kostoja e krahut të punës (teknikut të laboratorit) për orë pune	8,00 €	350	2 800,00 €	200	1600 €
b. stacione gjysmautomatike/tubat pasivë					- €
Mirëmbajtja vjetore	2500,00 €	4	10 000,00 €	4	10 000 €
Kostot e artikujve të konsumit dhe kostot funksionale të stacioneve gjysmautomatike	3000,00 €	4	12 000,00 €	4	12 000 €
Kostoja e fuqisë punëtore (teknikët) për orë pune	5,00 €	50	250,00 €	50	250 €
Kostot vjetore të peshimit të filtrave për monitorimin gravimetrik PM10	80,00 €	113	9040,00 €	113	9040 €
Analiza e HM (për kampion)	20,00 €	400	8000,00 €	400	8000 €
II. Kampionimi			- €		- €
Kostot e stafit (dietat) gjatë ditëve të punës	40,00 €	455	18 200,00 €	455	18 200 €
Kostot e udhëtimit (për mision)	50,00 €	40	2000,00 €	40	2000 €
Analiza dhe raportimi i të dhënave (ditë pune)	120,00 €	50	6000,00 €	50	6000 €
TOTAL			352 790,00 €		127 590 €

Moduli c – Analiza biokimike e ujërave sipërfaqësorë, nëntokësorë/ujërave për larje

Kostimi i kësaj kategorie varet shumë nga disponueshmëria e laboratorëve biokimikë me të gjitha pajisjet që janë në gjendje të bëjnë testimet dhe matjet e nevojshme.

Duke pasur parasysh numrin e popullatës mendohet se duhet të ketë së paku 2 laboratorë për ujën. Këto laboratorë duhet të jenë të pajisur me lloje të ndryshme spektrofotometrash, sisteme jonikë kromatografie, sisteme të absorbimit atomik, mikroskopë të ndryshëm, analizues për algat dhe pajisje të tjera analitike kimike dhe mbështetëse (ngrirës, furra etj.). Pajisjet e analizës biologjike përmbajnë: bankat e punës me fluks laminar, inkubatorë, llambat UV, analizues të ADN-së etj. Kostoja e një laboratorit të pajisur tërësisht në varësi të pajisjeve është me afërsi 500 000 – 800 000 euro.

Përveç pajisjeve laboratorike, monitorimi i cilësisë së ujit kërkon pajisje të lëvizshme për të matur parametrat në terren si p.sh. rrjedha, temperatura, oksigjen i tretur O₂, etj. Duke supozuar se do të ketë 247 stacione nga të cilët do të merren kampione (plani i monitorimit për vitin 2016: 151 për lumenjtë, 35 për liqenet, 33 për lagunat, 28 për ujërat tranzitore) parashikohet nevoja për 6 ekipe që do të marrin kampione për të realizuar programin vjetor të monitorimit që kërkohet nga WFD (për ujërat sipërfaqësorë), 4 prej të cilave do të marrin gjithashtu kampione për monitorimin biologjik (dy herë në vit). Një ekip shtesë do të nevojitet për monitorimin e ujërave nëntokësorë dhe dy të tjerë për cilësinë e ujit për larje.

Dietat janë përcaktuar te 5500 lekë (afërsisht 40 euro) për person dhe kostot mesatare të udhëtimit 63 euro.

Numri total i kampioneve që do të mblidhen çdo vit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5. : numri i kampioneve të ujit që kërkohen sipas llojit të ujit

	Stacionet	Numri i kampioneve në vit për çdo stacion	Total
Ujërat sipërfaqësorë	247	2	494
Ujërat nëntokësorë	39	2	78
Ujërat për larje	100	4	400
Total	386		972

Kategoritë e kostos vjetore për një cikël monitorimi gjashtë vjeçar paraqiten në tabelën e mëposhtme. Në këto kosto nuk përfshihen zhvillimi i sigurimit të cilësisë dhe politika e kontrollit që kërkohet.

Tabela 6 : Kostimi i modulit për monitorimin e ujit

	Kosto për njësi	Sasia	total
Ujërat sipërfaqësorë			

i. pajisjet			
Matës portativë (pH, O2 i tretur, kripësia, Temp)	800 €	6	4800 €
Peshkues elektrik	7500 €	4	30 000 €
Matës dhe kampione nënujore	800 €	2	1600 €
Kosto totale vjetore parashikohet 1/5)			7280
ii. kampione të ujit			
dietat (misioni = 3 stacione në ditë X 3 persona)	120 €	42	5040 €
dietat (misioni = 3 stacione në ditë X 2 persona)	80 €	283	22 640 €
Artikuj konsumi për kampion (doreza, kutitë për transferimin e kampioneve dhe kontejnerë paketimi)	9 €	972	8748 €
Kosto udhëtimi (për mision – duke përfshirë ruajtjen e kampioneve)	63 €	325	20 475 €
			56 903 €
iii. analiza e ujit (sipërfaqësor dhe nëntokësor)			
Statusi kimik	90 €	572	51 480 €
Substanca prioritare dhe ndotës	150 €	572	85 800 €
peshqit (vetëm në sipërfaqe - dy herë në vit)	120 €	124	14 880 €
diatoma dhe makrofite (vetëm në sipërfaqe - dy herë në vit 50% e stacioneve)	80 €	62	4960 €
jovertebrorët e mëdhenj jobentikë (vetëm në sipërfaqe -dy herë në vit)	150 €	124	18 600 €
Analiza mikrobiologjike e ujit nëntokësor	120 €	78	9360 €
			298 886 €

iv. Ujërat për larje			
dietat (misioni = 8 stacione në ditë X 2 persona)	80 €	13	1040 €
Artikuj konsumi për kampion (doreza, kuti për transferimin e kampioneve dhe kontejnerë për paketim)	9 €	100	900 €
Kosto udhëtimi (për mision)	50 €	10	500 €
Analiza mikrobiologjike	120 €	400	48 000 €
			50 440 €
			413 509

Vlerësimi për përlogaritjen e indikatorit "Intensiteti i shkarkimit në sektorin e brendshëm (shkarkime të lëngshme urbane)" është **15 000** euro.

Moduli d - Biodiversiteti

Monitorimi i biodiversitetit llogaritet kryesisht me muaj pune dhe konsiderohet se do të kontraktohet me jashtë. Kostot për njësi llogariten 120 euro në ditë në të gjitha rastet, me përjashtim të specieve detare dhe habitateve ku kostoja është 350 euro për ditë pune për shkak të pajisjeve të posaçme që kërkohen. Peshqit e ujërave të brendshëm nuk përfshihen në llogaritje, duke qenë se diversiteti i tyre kontrollohet nga vlerësimi i cilësisë së ujit. Programi për monitorimin e survejancës së biodiversitetit parashikohet të zgjasë 3 vjet.

Tabela 7 : Kostimi i modulit të biodiversitetit

biodiversiteti -Survejanca e sondazheve të statusit të konservimit	Kosto për njësi	Sasia	total
Habitatet dhe Flora ⁴	150,00 €	2000	225 000 €

⁴ Llogaritja e ngarkesës nuk përfshin habitatet e llojeve të pyjeve dhe florës që do të vlerësohen me anë të monitorimit të pyjeve.

Gjitarët	150,00 €	2200	330 000 €
Reptilë, amfibë	150,00 €	1000	150 000 €
Jovertebrorë	150,00 €	1000	150 000 €
Zogjtë	150,00 €	3500	525 000 €
Specie detare dhe habitatet	350,00 €	1500	525 000 €
Kosto e përgjithshme			1 980 000 €
Kosto vjetore			990 000 €

Moduli e. - Pyjet

Programi Kombëtar i Monitorimit (PKM) për vitin 2020 parashikon kriteret pan-evropiane C2 dhe C4 në procesin e monitorimit që do të zbatohen me angazhimin e stafit të AKM-së dhe në rast se ka mbështetje financiare, për indikatorin C2.1, largimin e ndotësve të ajrit, C2.2, statusi i dheut, dhe për C4.2, me përfshirjen e palëve të treta (ente publike dhe private shkencore). Zhvillimi i tyre do të bëjë të mundur përditësimin e informacionit në kuadër të plotësimit të objektivave të menjëhershme dhe afatmesme të efikasitetit në rigjenerimin e pyjeve dhe të prognozës së statusit të pyjeve dhe shëndetit.

Buxheti i parashikuar për ato detyra është **255 000 euro**.

Moduli f. – menaxhimi i mbetjeve/shkarkimeve industriale

